

STUDIM MBI NIVELIN E ARRITJEVE AKADEMIKE TË NXËNËSVE ME DËMTIME NË DËGJIM NË QENDRËN BURIMORE NËNA TEREZË NË PRIZREN



Co-funded
by the European Union



COUNCIL OF EUROPE



Co-funded and implemented
by the Council of Europe

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit “Ndërtimi i kapacitetit për Arsim Gjithëpërfshirës – INCLUDE” me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autorëve. Pikëpamjet e shprehura nuk reflektojnë në asnjë mënyrë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian ose Këshillit të Evropës. © Këshilli i Evropës, tetor 2023. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Licencuar në Bashkimin Evropian me kushte. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose transmetohet, në asnjë formë ose në asnjë mënyrë, elektronike (CD-ROM, Internet, etj.) ose mekanike, duke përfshirë fotokopjimin, regjistrimin ose ndonjë sistem të ruajtjes ose rikthimit të informacionit, pa lejen paraprake me shkrim nga Drejtoria e Komunikimit (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Përgatitur nga Marja MATERO dhe Gazmend TAHIRAJ

Cover image credits: Andrey Popov/shutterstock.com
Të gjitha kërkesat në lidhje me riprodhimin ose përkthimin e tërë dokumentit ose të një pjese të tij duhet t’i drejtohen Drejtorisë së Komunikimit. E gjithë korrespondenca tjetër në lidhje me këtë publikim duhet t’i drejtohet Departamentit të Arsimit, Divizionit për Bashkëpunim dhe Ngritje të Kapaciteteve të Këshillit të Evropës.
Departamenti i Përgatitjes i Këshillit të Evropës (SPDP) nuk është përgjegjës për faqosjen dhe e as përmbajtjen e tij.

Tetor 2023

Përmbajtja

AKRONIME	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
HYRJE	6
KONTEKSTI	8
DIZAJNI I HULUMTIMIT	11
Qasja metodologjike	11
Mbledhja e të dhënave	12
Kufizimet e studimit	13
RISHIKIMI I LITERATURËS	15
REZULTATET	23
Rezultatet e nxënësve	25
Rezultatet e prindërve	28
Rezultatet e stafit arsimor të shkollës	30
Rezultate të tjera	40
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	42
Përfundime	42
REKOMANDIME	48
REFERENCAT	49
SHTOJCAT	54
PYETËSORI PËR MËSIMDHËNËS DHE STAFIN TJETËR TË QENDRËS BURIMORE	54
INFORMATAT THEMELORE	54

Akronime

BE	Bashkimi Evropian
DHH	Të Shurdhër dhe me Vështirësi në Dëgjim
GjSh	Gjuha e Shenjave
GjShK	Gjuha e Shenjave Kosovare
INCLUDE	Projekti i Ngritjes së Kapaciteteve për Arsim Gjithëpërfshirës
IQSh	Instituti Qëndror për të Shurdhër
KiE	Këshilli i Evropës
KPL	Kuuntelen-Puhun-Luen
MFZhSA/ FSDEK	Mbështetja Finlandeze për Zhvillim të Sektorit të Arsimit
NVA	Nevojat e Veçanta Arsimore
PIA	Plani Individual Arsimor
QB	Qendra Burimore
SHKSH	Shoqata Kosovare e të Shurdhërve
ShVD	Të Shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim
MAShTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
TI	Teknologjia Informativ
UA	Udhëzim Administrativ

Përmbledhje ekzekutive

Gjatë 15 viteve të fundit, ka pasur përpjekje të shumta për të promovuar arsimin dy-gjuhësor për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim në përputhje me kurrikulën. Pavarësisht se janë ndërmarrë shumë veprime konkrete për shfrytëzimin dhe zhvillimin e metodave të mësimdhënies dy-gjuhësore, palë të ndryshme të interesit kanë shprehur shqetësim të qartë dhe në rritje për nivelet e pakënaqshme të të nxënësve dhe veçanërisht arritjet e nxënësve në lexim dhe shkrim. Ky studim u përpilua për të ofruar një pasqyrë të saktë të situatës në fjalë.

Fokusi kryesor i studimit ishte të marrë informacion mbi qasjen në gjuhë dhe mësimin e gjuhëve, si dhe mbi nivelet e shkrim-leximit në mesin e nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim në Qendrën Burimore Nëna Terezë. Duke qenë se ekzistonte një ide paraprake për nivelet e pakënaqshme të arritjeve në lexim të nxënësve në shkollë, në studim u krye një test i shkathtësive të leximit të nxënësve. Rezultatet e testit mbështetën idenë paraprake duke treguar se nxënësit e testuar nuk kanë shkathtësi leximi. Andaj, synimet e mëtejshme ishin të lundroheshin dhe trajtoheshin shkaqet rrënjësore të problemit që mund të pengojnë nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim të arrijnë nivele të kënaqshme të kompetencave akademike dhe të jepnin rekomandime për palët e ndryshme të interesit se si mund të përmirësonin situatën.

Qëllimi ishte të mblidhte informacion mbi pesë fushat kryesore në vijim ku secila kontribuon në objektivin kryesor që është arritja e nivelit të arritjeve të përcaktuara në kurrikulë: 1) Qasja në gjuhë dhe praktikën e hershme të shkrim-leximit midis nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim; 2) Shkathtësitë e shkrim-leximit dhe shkrim-leximi shumëgjuhësh i nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim; 3) Praktikën e mësimdhënësve dhe asistentëve të klasës kur ndër-veprojnë me nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim; 4) Mjediset dhe materialet mësimore brenda dhe jashtë shkollës; dhe 5) Kuptimi i rrugëve drejt shkrim-leximit, shkathtësitë gjuhësore dhe arritjet e larta akademike të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim.

Ky studim cilësor përdori qasjen e kërkimit etnografik dhe të dhënat u mblodhën duke përdorur metoda të ndryshme. Testin e shkathtësive të leximit për nxënësit, intervistat në fokus grupe në shkollë, intervistat e drejtorit, zyrtarit nga MASHTI dhe përfaqësuesve të Shoqatës Kosovare të të Shurdhërve. Përveç kësaj, janë bërë vëzhgime në klasa dhe anketa shtesë. Të dhënat u mblodhën gjatë udhëtimit në terren në maj 2023.

Testi i shkathtësive të leximit tregoi se asnjë nga 14 nxënësit e testuar nga klasa 4 deri në 12 nuk arrin të lexojë dhe kuptojë as edhe fjali të thjeshta, dhe arsyt kryesore për këtë janë mungesa e gjuhës së shenjave dhe shkathtësive pedagogjike të mësimdhënësve, mungesa e materialeve të përdorura në mësimdhënie, mungesa e angazhimit të përkthyesve të GjSh-së dhe mungesa e gjuhës së shenjave si lëndë për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim.

Rezultatet e studimit do të shfrytëzohen nga MASHTI dhe akterë të tjerë në mbështetjen e përmirësimit të arsimit të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim në Kosovë.

Hyrje

Ky studim është pjesë e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës “Ndërtimi i Kapaciteteve për Gjithëpërfshirje në Arsim – INCLUDE”.

Objektivi i përgjithshëm i projektit INCLUDE synon përmirësimin e qasjes në arsimin cilësor të nxënësve nga grupet e pafavorizuara në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm - në përputhje me politikat dhe prioritetet e brendshme të Përfituesit dhe standardet dhe praktikrat e Këshillit të Evropës. Një nga objektivat specifike të projektit është forcimi i kapacitetit të sistemit arsimor të Kosovës për të përmirësuar pjesëmarrjen dhe mbështetjen e shërbimeve për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm.

Qendra Burimore (QB) Nëna Terezë në Prizren ofron arsimim për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim. Gjatë 15 viteve të fundit, shkolla është mbështetur në shumë mënyra për të përmirësuar cilësinë e arsimit për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim. Janë ofruar trajnime për gjuhën e shenjave, edukimin dy-gjuhësor dhe strategjitë e mësimdhënies për edukimin e nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim dhe shkolla është pajisur me përkthyes të gjuhës së shenjave dhe asistentë të klasës për të mbështetur nxënësit dhe mësimdhënësit në klasë. Që nga viti 2016, një instruktor i gjuhës së shenjave ka trajnuar stafin arsimor të QB-së për Gjuhën e Shenjave Kosovare.

Pavarësisht këtyre përpjekjeve, arritjet mësimore të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim nuk janë përmirësuar dhe palët e ndryshme të interesit kanë shprehur shqetësimin e tyre të qartë dhe në rritje për arritjet e pakënaqshme. Prandaj, ky studim ishte i nevojshëm për të vlerësuar situatën ekzistuese dhe për të gjetur arsyet e nivelit të ulët të arritjeve veçanërisht në shkathtësitë e shkrim-leximit të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim në kontekstin shkollor.

Qëllimet kryesore të studimit ishin të:

- 1)** marrë informacion mbi qasjen në gjuhë dhe mësimin e gjuhëve.
- 2)** marrë informacion mbi nivelet e shkrim-leximit në mesin e nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim; dhe të lundrojë dhe adresojë shkaqet rrënjësore të problemit që mund t'i pengojë këta të fundit të arrijnë nivele të kënaqshme të kompetencave akademike.
- 3)** ofrojë rekomandime për palët e ndryshme të interesit se si të përmirësohet arsimimi i nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim në Kosovë.

Për më tepër, studimi synoi të hedhë dritë mbi ‘praktikat më të mira’ të gjetura në shkollën speciale

QB Nëna Terezë që mundësojnë arritje më të larta dhe të evidentojë çdo tension ekzistues midis praktikave të përditshme ndërvepruese dhe politikave që promovojnë arsimin gjithëpërfshirës, si dhe të propozojë veprime për arsim të qasshëm dhe gjithëpërfshirës dhe të krijojë perspektiva të reja për zhvillimin e arsimit për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim.

Qëllimi ishte të merrej informacion mbi pesë fushat kryesore në vijim ku secila kontribuon në objektivin kryesor që është arritja e nivelit të arritjeve të përcaktuara në kurrikulë:

- 1) Qasja në gjuhë dhe praktikat e hershme të shkrim-leximit midis nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim;
- 2) Shkathtësitë e shkrim-leximit dhe shkrim-leximi shumëgjuhësh i nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim;
- 3) Praktikrat e mësimdhënësve dhe asistentëve të klasës kur ndër-veprojnë me nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim;
- 4) Mjediset dhe materialet mësimore brenda dhe jashtë shkollës; dhe
- 5) Kuptimi i rrugëve drejt shkrim-leximit, shkathtësitë gjuhësore dhe arritjet e larta akademike të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim.

Ky studim cilësor përdori qasjen e hulumtimit etnografik, dhe të dhënat u mbledhën duke përdorur metoda të ndryshme: testin e shkathtësive të leximit për nxënësit, intervistat në fokus grupe në shkollë, intervistat e drejtorit, zyrtarit nga MASHTI dhe përfaqësuesve të Shoqatës Kosovare të të Shurdhërve. Përveç kësaj, u bënë vëzhgime në pesë klasa dhe u zhvillua një anketë e mësimdhënësve në internet. Të dhënat u mbledhën gjatë udhëtimit në terren në maj 2023.

Që nga ideja paraprake e niveleve të pakënaqshme të arritjeve në lexim, u testuan shkathtësitë e leximit të 14 nxënësve nga klasa 4 deri në 12. Rezultatet treguan se të gjithë nxënësit e testuar nuk janë në gjendje të lexojnë dhe kuptojnë as edhe fjali të thjeshta. Për të shqyrtuar shkaqet kryesore të problemit, të dhënat u mbledhën gjatë udhëtimit në terren në maj 2023. Janë organizuar intervista në fokus grup me 11 nxënës, 11 prindër, 7 mësimdhënës, 3 asistentë të klasës, 2 përkthyes të gjuhës së shenjave (GjSh), një instruktor të GjSh-së dhe intervista me drejtorin, një zyrtar të MASHTI-t dhe 2 anëtarë të Shoqatës Kosovare të të Shurdhërve. Vizitat në klasa u bënë për të vëzhguar praktikrat në klasë dhe u krye një anketë e mësimdhënësve në internet.

Rezultatet e studimit do të shfrytëzohen nga MASHTI dhe akterë të tjerë për të mbështetur përmirësimin e arsimit të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim në Kosovë.

Konteksti

Qendra Burimore (QB) Nëna Terezë në Prizren është njëra nga pesë ish-shkollat speciale të cilat janë transformuar për të funksionuar edhe si QB në Kosovë. Procesi i transformimit filloi në vitin 2007 me mbështetjen e projektit Mbështetja Finlandeze për Sektorin e Arsimit në Kosovë (FSDEK) II. Më vonë, puna e QB-ve u rregullua me Ligjin për Arsimin Parauniversitar në vitin 2011 dhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 23/2013 i cili tregon dy funksionet kryesore të QB-ve: një shkollë speciale dhe qendër burimore e cila ofron mbështetje për shkollat e zakonshme në Kosovë.

Detyrat e shkollave speciale në QB përfshijnë p.sh., ofrimin e programeve për NVE-të, shërbimet e mësimdhënies dhe rehabilitimit për fëmijët me aftësi të kufizuara; përgatitjen e PIA-ve për nxënësit; bashkëpunimin me prindërit dhe institucionet përkatëse; sigurimin e akomodimit të nxënësve në konvikte, organizimin e aktiviteteve jashtë shkollës; dhe sigurimin e vakteve ditore për nxënësit në QB. Detyrat e Qendrave Burimore përfshijnë ofrimin e shërbimeve mbështetëse për shkollat e rregullta në lidhje me mësimdhënien dhe të nxënësit e nxënësve me NVA. Këto shërbime ofrohen kryesisht nga mësimdhënësit shëtitës.

QB Nëna Terezë është shkolla e vetme në Kosovë që është e specializuar në edukimin e nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim (ShVD). Për më tepër, në shkolla të rregullta janë dy klasa të bashkëngjitura për nxënës të ShVD: një në shkollën Elena Gjika në Prishtinë dhe një në shkollën Rexhep Elmazi në Gjilan, e poashtu ka nxënës të ShVD edhe në shkolla të tjera të rregullta.

Gjatë 15 viteve të fundit janë bërë shumë përpjekje për të përmirësuar cilësinë e arsimit të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim në Kosovë. Siç u përmend më lart, Ligji për Arsimin Parauniversitar (2011) dhe Udhëzimi Administrativ (2013) për qendrat burimore ofrojnë kornizën ligjore edhe për arsimimin e nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim. Shoqata e të Shurdhërve të Kosovës (SHAK) në bashkëpunim me MASHTI-n ka trajnuar instruktorët e gjuhës së shenjave dhe asistentin e klasës. Si rezultat, 15 interpretë të gjuhës së shenjave për të përmbushur nevojat e komunitetit të shurdhër dhe asistentë shkollorë u certifikuan nga MASHTI në vitin 2015. Mësimdhënësit e parë shëtitës për të mbështetur shkollat e zakonshme u punësuan në vitin 2007.

Shoqata Kosovare e të Shurdhërve në bashkëpunim me MASHTI-n publikoi Udhëzuesin për Arsim Gjithëpërfshirës, Dygjuhësinë dhe Gjuhën e Shenjave për fëmijët me dëmtime në dëgjim në vitin 2019. Udhëzuesi ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi arsimin aktual të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim në Kosovë, modalitetet se si të vazhdohet me zhvillimin dhe përmirësimin e arsimit të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim; dhe udhëzime për shkollat, mësimdhënësit dhe prindërit për nevojat specifike të këtyre të fundit. (MASHTI, 2019).

E drejta e fëmijëve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim për gjuhën e shenjave parashikohet në Ligjin për Arsimin Parauniversitar (Neni 43): "Fëmijëve dhe nxënësve që e përdorin gjuhën e

shenjave si gjuhë të parë duhet t'u ofrohet mësim në gjuhën e shenjave." Gjuha e mësimin në shkollën Nëna Terezë është gjuha e shenjave (MASHTI, 2019.)

Qëllimet e edukimit dy-gjuhësor për nxënësit me vështirësi në dëgjim siç tregohen në Udhëzuesin për Arsimin Gjithëpërfshirës, Dygjuhësinë dhe Gjuhën e Shenjave për fëmijët me dëmtime në dëgjim (MASHTI, 2019) janë si më poshtë:

- T'u mundësojë fëmijëve me dëmtime në dëgjim të jenë të aftë gjuhësisht.
- T'u sigurojë qasje në një kurrikulë të gjerë.
- T'u mundësojë aftësi të mira të shkrim-leximit; dhe
- T'u ofrojë nxënësve me dëmtime në dëgjim një ndjenjë pozitive lidhur me identitetin e tyre.

Sipas Udhëzimit, arsimimi i fëmijëve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim në Kosovë përballet me sfidat e mëposhtme:

- Mungesa e të dhënave për fëmijët e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim, e cila shkakton probleme në planifikimin dhe buxhetimin e burimeve dhe shërbimeve efikase të cilat bazohen në nevojat e fëmijëve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim.
- Mungesa e stafit dhe burimeve për gjuhën e shenjave, dhe ekspertë që mund të punojnë në hartimin e kurrikulave dhe teksteve në gjuhën e shenjave.
- Buxheti i kufizuar i cili është i dukshëm përgjithësisht në fushën e arsimit dhe veçanërisht me fëmijët e grupeve të marginalizuara që kërkojnë shumë burime njerëzore, pajisje ndihmëse dhe mjete mësimore specifike didaktike.
- Buxheti i kufizuar për punësimin e stafit, shërbimet dhe mallrat.
- Cilësi e dobët e shërbimeve dhe arsimit
- Mungesa e profesionistëve
- Mungesa e njohurive për metodologjitë e edukimit të të shurdhërve dhe aftësive të GjSh tek mësimdhënësit
- Mungesa e bashkëpunimit me shkolla të ngjashme në vende të tjera.

Në shkollën QB Nëna Terezë personeli ka marrë shumë trajnime të vazhdueshme për gjuhën e shenjave, dygjuhësinë dhe metodologjitë për edukimin e nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim. Shërbimet në shkollë janë përmirësuar që kur janë punësuar përkthyes të gjuhës së shenjave, asistentët e klasës dhe një instruktor i GjSh-së. Aktualisht stafi që punon me nxënës përbëhet nga drejtori, 24 mësimdhënësit, 2 përkthyes të GjSh-së, 3 asistentë të klasës, një instruktor i GjSh-së, një psikolog, 3 edukatore dhe 4 infermiere. Shumë prej tyre kanë punuar në shkollë prej dekadash.

Nxënësit në shkollë vijnë nga pjesë të ndryshme të Kosovës dhe shumë prej tyre gjatë ditëve të shkollës akomodohen në konviktet e shkollës. Gjatë 10 viteve të fundit regjistrimi në shkollë është ulur pasi shumica e prindërve i dërgojnë fëmijët e tyre të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim në shkollat e zakonshme afër shtëpisë. Aktualisht janë 34 nxënës dhe gati një e treta e tyre janë nxënës që dëgjojnë por me nevoja të veçanta arsimore të shkaktuara nga p.sh. autizmi dhe paaftësitë intelektuale.

Për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim, në QB, përdoret kurrikula e përgjithshme, përgatiten Planet Individuale Arsimore (PIA), gjersa librat shkollor të përdorur janë të njëjtë si në të gjitha shkollat e zakonshme. Nxënësit e shkollës nuk marrin pjesë në provimet kombëtare.

Përkundër të gjitha përpjekjeve për të përmirësuar cilësinë e arsimit në shkollë, nxënësit nuk mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë. Të lexuarit është një aftësi themelore që qëndron në qendër të suksesit në të gjitha fushat akademike dhe nxënësit që përjetojnë vështirësi në lexim ka të ngjarë të përjetojnë vështirësi edhe në fushat e lëndëve akademike (Rose, S. dhe të tjerë. 2022). Ky studim synon të gjejë arsyet pse nxënësit mbeten analfabetë dhe të gjej zgjdhje se çfarë duhet të bëhet në këtë drejtim.

Dizajni i hulumtimit

Ky studim cilësor është realizuar në Qendrën Burimore Nëna Terezë në Prizren.

Qëllimet kryesore të studimit ishin të:

- 1) marrë informacion mbi qasjen në gjuhë dhe mësimin e gjuhëve, si dhe
- 2) marrë informacion mbi nivelet e shkrim-leximit në mesin e nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim; dhe të lundrojë dhe adresojë shkaqet rrënjësore të problemit që mund t'i pengojë këta të fundit të arrijnë nivele të kënaqshme të kompetencave akademike; dhe
- 3) ofrojë rekomandime për palët e ndryshme të interesit se si të përmirësohet arsimimi i nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim në Kosovë.

Gjithashtu, studimi synonte të propozonte veprime për arsim të qashtëm dhe të krijonte perspektiva të reja për zhvillimin e arsimit për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim; për të hedhur dritë mbi “praktikat më të mira” të gjetura në shkollën QB Nëna Terezë që mundësojnë arritje më të larta; dhe për të nxjerrë në pah çdo tension ekzistues midis praktikave të përditshme ndërvepruese dhe politikave që promovojnë arsimin gjithëpërfshirës.

Qëllimi ishte të mbledhë informacion mbi pesë fushat kryesore në vijim ku secila kontribuon në objektivin kryesor që është arritja e nivelit të arritjeve të përcaktuara në kurrikulë:

- 1) Qasja në gjuhë dhe praktikat e hershme të shkrim-leximit midis nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim;
- 2) Shkathtësitë e shkrim-leximit dhe shkrim-leximi shumëgjuhësh i nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim;
- 3) Praktikat e mësimdhënësve dhe asistentëve të klasës kur ndër-veprojnë me nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim;
- 4) Mjediset dhe materialet mësimore brenda dhe jashtë shkollës; dhe
- 5) Kuptimi i rrugëve drejt shkrim-leximit, shkathtësitë gjuhësore dhe arritjet e larta akademike të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim.

Këto pesë fusha ishin temat në intervistat e fokus grupeve. Për çdo intervistë në fokus grup u përgatitën pyetje gjysmë të strukturuar në lidhje me këto tema.

Qasja metodologjike

Ky studim cilësor përdori qasjen e kërkimit etnografik. Studimi bazohet në lloje të ndryshme të dhënash, dhe përdorimin e të dhënave të shumta që forcon besueshmërinë e studimit. Për shembull, ndërsa intervistat japin informacion për atë që pjesëmarrësit mendojnë se bëjnë, vëzhgimet neutrale japin informacion mbi veprimet dhe orientimet konkrete, dhe të përditshme.

Në këtë studim, të dhënat u mbledhën duke përdorur metoda të ndryshme: testin e shkathtësive të shkrim-leximit për nxënësit, intervistat në fokus grupe në shkollë, intervistat e drejtorit, zyrtarit nga MASHTI dhe përfaqësuesve të Shoqatës Kosovare të të Shurdhërve, vëzhgimet në klasa dhe një anketë e mësimdhënësve në internet.

Fokusi parësor i analizës ishte në grupin e të dhënave të nxënësve, i cili përfshinte intervistat e nxënësve dhe testin e shkathtësive të shkrim-leximit për të zbuluar se cilat janë kompetencat e të lexuarit dhe të shkruarit të nxënësve. Analiza e këtij grupi të të dhënave të nxënësve shërbeu si pikënisje për studimin e përgjithshëm dhe të dhëna të tjera ishin për të sqaruar arsyet pse nxënësit ose arrijnë ose nuk arrijnë kompetencat e pritura përmes arsimit.

Mbledhja e të dhënave

Të dhënat u mbledhën gjatë udhëtimit në terren në maj , 2023. Të dhënat u mbledhën përmes metodave të mëposhtme:

- 7 intervistave të cilat në fokus grupe kishin nxënësit, mësimdhënësit, personelin tjetër arsimor (përkthyes, asistentë në klasë dhe instruktor të GjSh-së) dhe anëtarë të tjerë të stafit (edukatorë dhe infermierë)
- Intervistave të palëve kryesore të interesit (drejtori i QB-së, një zyrtar i MASHTI-t dhe përfaqësues të Shoqatës së të Shurdhërve të Kosovës)
- Vëzhgimeve në klasë/shkollë
- Testit të shkathtësive të shkrim-leximit për nxënësit
- Anketës në internet për mësimdhënësit dhe edukatorët

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në fokus grupe dhe intervista individuale ishte 11 nxënës dhe 28 të rritur.

Fokus grupet ishin si më poshtë:

Nxënësit e grupit A:	6 nxënës të shurdhër nga klasa 9 deri në 12
Nxënësit e grupit B:	5 nxënës të shurdhër nga klasa 4, 6, 7 dhe 9
Prindërit e grupit A:	6 prindër të shurdhër
Prindërit e grupit B:	5 prindër që dëgjojnë (njëri me një fëmijë me autizëm)
Grupi i mësuesve:	7 mësimdhënës
Stafi i grupit A:	2 përkthyes të gjuhës së shenjave, 1 instruktor i GjSh-së (i shurdhër) dhe 3 asistentë në klasë (të shurdhër)
Stafi i grupit B:	3 edukatore dhe 2 infermiere

Intervistat e palëve kryesore të interesit synonin të merrnin informacion mbi nevojat aktuale dhe disponueshmërinë e burimeve për të mbështetur si stafin arsimor ashtu edhe nxënësit në shkollë. Drejtori është intervistuar në shkollë, ndërsa zyrtari i MASHTI-t dhe 2 përfaqësuesit e SHKSH-së janë intervistuar në Prishtinë.

Të gjitha intervistat u transkriptuan dhe analiza e të dhënave të grumbulluara u kombinua nga fokus grupi dhe intervistat individuale duke ndjekur pesë fushat kryesore të studimit.

Katërmbëdhjetë nxënës morën pjesë në testin e shkathtësive të shkrim-leximit. Qëllimi ishte testimi i nxënësve për rrjedhshmërinë e tyre në lexim dhe të kuptuarit e të lexuarit. Testi dhe rezultatet janë përshkruar në kapitullin vijues. Vëzhgimet janë bërë në 4 klasa dhe ato janë raportuar në kapitujt në vijim.

Gjatë mbledhjes së të dhënave përmes intervistave dhe vëzhgimeve në klasë, u vu re se shkolla dhe mësimitdhënësit përdorin kurrikulën e përgjithshme dhe të njëjtat libra si në shkollat e zakonshme për nxënësit që dëgjojnë. Mësimitdhënësit raportuan se kanë përgatitur Plane Individuale Arsimore (PIA), për nxënësit.

Anketa e mësimitdhënësve në internet

Anketa e mësimitdhënësve në internet u krijua si një mjet shtesë për të përfshirë më shumë njerëz në studim dhe për të mbledhur më shumë informacion rreth perceptimit të mësimitdhënësve dhe edukatorëve për procesin e mësimitdhënies dhe të të nxënësve dhe arritjet e nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim.

Pyetësori (shih shtojcën) përbëhej nga 30 pyetje sasiore dhe 2 pyetje të hapura. Pyetjet u hartuan për të mbledhur informacion mbi perceptimin e mësimitdhënësve dhe edukatorëve për infrastrukturën e shkollës, kurrikulën shkollore, materialet mësimore, aftësitë e mësimitdhënësve në gjuhën e shenjave, arritjet e nxënësve dhe bashkëpunimin me prindërit.

Pyetësori u përpilua në atë mënyrë që të kishte pyetje me përgjigje të shumëfishta me shkallën Likert dhe pyetje të hapura. Ideja me pyetje të hapura ishte mbledhja e informacionit më të thelluar në lidhje me sfidat dhe idetë për përmirësimin e edukimit të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim.

Linku i pyetësorit në internet iu dërgua të gjithë mësimitdhënësve dhe edukatorëve. Pyetësori ishte i hapur për përgjigje për dy javë. Janë marrë 20 përgjigje duke përfshirë mësimitdhënësit, edukatorët dhe drejtorin e shkollës.

Kufizimet e studimit

Kufizimet e studimit ishin si në vijim:

- 1) Në mostrën e përzgjedhur për nxënësit që do të testoheshin me shkrim në gjuhën shqipe, nuk ishte e mundur që mostra të zgjedhet sipas rastit për shkak të numrit të vogël të nxënësve në shkollë. Andaj mostra e nxënësve përfshinë nxënësit nga klasa 4 – 12 për t'i testuar aftësitë e tyre me mosha të ndryshme, në mënyrë që mostra të jetë sa më reprezentative.

- 2) Koha e shkurtër për mbledhjen e të dhënave nuk mundësoi testimin dhe vlerësimin e aftësive të ndryshme akademike të nxënësve të ShVD si dhe vëzhgime në klasë gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- 3) Nuk ka pasur kohë as resurse për t`u thelluar më tepër në intervista personale me mësimdhënës, nxënës dhe prindër për të mbledhur më tepër fakte rreth faktorëve themelor, sfidave dhe të arriturave të pakta akademike të nxënësve të shurdhër në shkollë. Kjo mund të ndikojë që rekomandimet lidhur me ndërhyrjet akademike komplekse lidhur me përmirësimin e rezultateve të nxënësve të mos jenë specifike. Mirëpo, ndërvalidimi i të dhënave të pranuar nga pjesëmarrës të ndryshëm në studim si dhe ndonjë vëzhgim në klasë do të hedhin mjaftë dritë në çështjet që dukeshin problematike për arsimimin e fëmijëve të shurdhër.
- 4) Meqë hulumtuesit nuk kanë njohuri të gjuhës së shenjave, komunikimi gjatë diskutimeve në fokus grupe me nxënësit dhe të rriturit e shurdhër si dhe vëzhgimet në klasë vareshin nga interpretimi nga gjuha e shenjave. Kjo pengoi kuptimin e drejt për drejtë të asaj se çfarë thuhet në gjuhën e shenjave dhe për të vlerësuar drejt për së drejti aftësitë e mësimdhënësve në gjuhën e shenjave. Mirëpo, ndër-vlerësimi i të intervistuarve dhe vëzhgimet në klasë u bënë për të pasur një pasqyrë më të mirë të çështjeve që ishin me rëndësi të eksplororeshin.

Rishikimi i literaturës

Arritja akademike e të shurdhërve dhe atyre me vështirësi në dëgjim është rezultat i një ndërveprimi të ndërlikuar të shumë faktorëve, duke përfshirë faktorët që janë thelbësorë për vetë nxënësit, të tillë si shkathtësitë gjuhësore shprehëse dhe pranuese, karakteristikat familjare dhe përvojat e nxënësve brenda dhe jashtë shkollës. (Marschark dhe të tjerë, 2015).

Fokusi i rishikimit të literaturës është në shqyrtimin e faktorëve që lidhen meqatishmërinë e fëmijëve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim për të mësuar një gjuhë të shkruar: cilësinë e humbjes së dëgjimit, faktorët familjarë, përvetësimin e hershëm të një gjuhe, qasjen në arsimin dygjuhësh dhe praktikën e mësimdhënies dhe metodologjisë për edukimin e nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim. Rishikimi njeh rëndësinë e Udhëzuesit për Arsimin Gjithëpërfshirës, Dygjuhësinë dhe Gjuhën e Shenjave për fëmijët me dëmtime në dëgjim (MASHTI, 2019) si referencë pasi që ofron informacione dhe udhëzues të përshtatur për kontekstin e Kosovës.

Qasja në gjuhë dhe praktikën e hershme të shkrim-leximit midis nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim

Lloji dhe cilësia e humbjes së dëgjimit përcakton mundësitë e nxënësit për të përvetësuar gjuhën e folur, pasi shkalla e humbjes së dëgjimit varion nga humbja e lehtë e dëgjimit deri tek shurdhimi. Shumica e nxënësve me dëmtim të dëgjimit kanë humbje të lehtë ose të moderuar të dëgjimit. Ata mund të dëgjojnë me ndihmën e aparateve të dëgjimit ose implanteve kokleare, dhe zakonisht komunikojnë me një gjuhë të folur, të mbështetur nga të folurit e gojës, të folurit me shenjë dhe shenja të mbështetura që mund të përdoren në mësimdhënie për të mbështetur të kuptuarit. Njerëzit me vështirësi në dëgjim identifikohen kryesisht me popullsinë që dëgjon. (MASHTI, 2019; Savolainen, A. dhe të tjerë, 2020.)

Nxënësit e shurdhër kryesisht kanë një humbje të thellë të dëgjimit, që do të thotë se ata kanë shumë pak ose aspak dëgjim (MASHTI, 2019). Shurdhimi perceptohet ndryshe në kulturën e shurdhër sesa në kulturën e dëgjimit. Sipas këndvështrimit socio-kulturor, personat e shurdhër përfaqësojnë një pakicë kulturore dhe gjuhësore dhe shurdhimi nuk konsiderohet aftësi e kufizuar. Personat e shurdhër e quajnë veten përdorues të gjuhës së shenjave ose të shurdhër dhe pa dëgjim të dëmtuar. Gjuha amtare ose gjuha e parë e të shurdhërve është gjuha e shenjave dhe ata mësojnë një gjuhë të shkruar si gjuhë të dytë. (Takala, M., & Sume, H., 2015; Tupi, E. 2019, Valteri 2023.)

Meqenëse pjesa më e madhe e të mësuarit brenda dhe jashtë shkollës ndërmjetësohet nga gjuha, nxënësit duhet të kenë një gjuhë të parë të zhvilluar plotësisht për të përjetuar sukses apo rezultate në shkollë. (Dostal, H. & të tjerë, 2017).

Për të zotuar një gjuhë të parë të zhvilluar plotësisht, ndërveprimi dhe zhvillimi gjuhësor në vitet e para të jetës janë shumë të rëndësishme për zhvillimin kognitiv dhe social të fëmijës dhe më vonë për përvetësimin e shkathtësive të shkrim-leximit dhe atyre akademike (Tupi, E. 2019; Savolainen, A. 2020).

Studimet e përvetësimit të gjuhës së shenjave tek fëmijët tregojnë se zhvillimi i gjuhës së shenjave është i krahasueshëm me zhvillimin e gjuhës së folur dhe se rrjedhshmëria e hershme në gjuhën e shenjave çon në piketa ekuivalente të nivelit të fjalëve dhe fjalive dhe shkathtësive pragmatike. (Swanwick, R. 2016.)

Historia familjare e një fëmije të shurdhër luan një rol të rëndësishëm në përvetësimin e hershëm të gjuhës së parë. Nëse fëmija i shurdhër lind në një familje me prindër të shurdhër, fëmija ka qasje në një gjuhë natyrale të shenjave që nga lindja. Megjithatë, vetëm një pjesë e vogël e fëmijëve të shurdhër lindin nga prindër të shurdhër. (Marschark dhe të tjerë, 2015; Tupi, E. 2019; Savolainen, A. 2020.) Shumica e fëmijëve të shurdhër lindin nga prindër që dëgjojnë, gjuha amtare e të cilëve është gjuha e folur dhe për shkak të humbjes së dëgjimit, qasja e fëmijëve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim në gjuhën e folur është e kufizuar. Kështu, zhvillimi i rrjedhshmërisë së gjuhës së shenjave për këta fëmijë që nuk dëgjojnë është problematik dhe shumica e tyre arrijnë në shkollë me vonesa të konsiderueshme në zhvillimin e gjuhës së shenjave. (Swanwick, R. 2016; Knoors & Marshark, 2012.)

Prindërit që dëgjojnë të një fëmije të shurdhër zakonisht nuk kanë njohuri të mëparshme rreth gjuhës së shenjave dhe ata nuk janë të vetëdijshëm se çfarë do të thotë mësimi i gjuhës së shenjave si për fëmijët e shurdhër, ashtu edhe për familjet e tyre. Për më tepër, ekzistojnë ende supozime të rreme se mësimi i gjuhës së shenjave mund të pengojë zhvillimin e gjuhës së folur dhe familjeve shpesh u ngulitet në kokë se duhet të zgjedhin vetëm gjuhën e shenjave ose gjuhën e folur në vend që të jenë në gjendje t'i kenë të dyja. Sidoqoftë, gjuha e shenjave nuk duhet të konsiderohet një alternativë nëse trajnimi i të folurit dështon, gjë që do të nënkuptonte humbjen e kohës së vlefshme në një periudhë të ndjeshme të përvetësimit të gjuhës, por gjuha e shenjave duhet t'i mësohet një fëmije të Shurdhër sa më shpejt që të jetë e mundur. Prindërve duhet t'u sigurohet informacioni i duhur në lidhje me zhvillimin gjuhësor të një fëmije të Shurdhër dhe, prindërit duhet të trajnohen në gjuhën e shenjave për të mbështetur fëmijët e tyre të shurdhër të mësojnë gjuhën e shenjave sa më shpejt që të jetë e mundur (Tupi, E. 2019.)

Një qasje dygjuhëshe kombinon gjuhën e shenjave me gjuhën e shkruar/të folur të komunitetit përreth (p.sh., shqip). Përvetësimi i hershëm i gjuhës së shenjave dhe dygjuhësisë është i lidhur fort me zhvillimin e përgjithshëm kognitiv, akademik dhe gjuhësor pasi parandalon mundësinë e vonesave në zhvillimin njohës dhe gjuhësor dhe mbështet një gjuhë të folur/të shkruar. Përveç kësaj, gjuha e shenjave dhe zhvillimi i dygjuhësisë ruan zhvillimin social dhe emocional të fëmijës dhe përdorimi i GjSh-së redukton zhgënjimin tek fëmijët e vegjël duke u ofruar atyre një mënyrë për t'u shprehur. (MASHTI, 2019.)

Pa mbështetje dhe burime për të mësuar gjuhën e shenjave, një fëmijë i shurdhër mund të rritet pa asnjë gjuhë që mund të ketë ndikim afatgjatë në të gjitha aspektet e jetës (p.sh. mirëqenien sociale, mendore dhe ekonomike, qasjen në arsim, punësim dhe shoqëri. (Tupi, E. 2019.)

Shkathtësitë e shkrim-leximit dhe shkrim-leximi shumëgjuhësh i nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim

Shkathtësitë e shkrim-leximit të fëmijëve të shurdhër përgjithësisht mbeten prapa atyre të bashkëmoshatarëve të tyre që dëgjojnë (Rudner dhe të tjerë., 2015). Të mësuarit për të lexuar ndikohet fuqimisht nga prejardhjet e ndryshme të fëmijëve dhe një bazë e fortë në gjuhën amtare ose në gjuhën e parë mbështet të mësuarit për të lexuar (Mayer & Trezek 2014), dhe ky është gjithashtu rasti në mesin e fëmijëve të Shurdhër. Njohuritë e gjuhës së shenjave parashikojnë shkathtësinë e nxënësve të Shurdhër që të mësojnë të lexojnë. Ndërgjegjësimi për fonologjinë e gjuhës së shenjave dhe strukturën gjuhësore duket se ndihmon një nxënës të Shurdhër me GjSh-në në procesin e të mësuarit të leximit kur ai ose ajo mund të krahasojë dallimet midis GjSh-së dhe gjuhës së shkruar në vetëdijen e tij/saj fonetike. (MASHTI 2019; Savolainen, A. 2020; Rudner dhe të tjerë., 2015; Mayer & Trezek 2014.)

Nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim kanë një shumëllojshmëri historish gjuhësore dhe preferencash komunikimi të cilat kanë implikime të ndryshme për zhvillimin e shkrim-leximit në shkollë.

- 1) Disa nxënës të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim mësojnë gjuhën e shenjave si gjuhë të tyre të parë, dhe më pas e mësojnë gjuhën e shkruar dhe/ose të folur si gjuhë të dytë në shtëpi ose në shkollë. Meqenëse ata kanë një bazë të fortë në GjSh, ata janë të aftë të zhvillojnë shkathtësitë e shkrim-leximit si bashkëmoshatarët e tyre që dëgjojnë, veçanërisht kur u jepet qasje në kurrikulën dhe gjuhën e klasës.
- 2) Nxënësit e tjerë të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim e mësojnë gjuhën e folur si gjuhën e tyre të parë duke përdorur dëgjimin e mbetur apo dëgjimin e mbetur me ndihmën e aparatit të dëgjimit ose implantit koklear dhe arrijnë ta zhvillojnë plotësisht gjuhën e folur si gjuhën e tyre të parë kur të vijnë shkollën. Ata mund të kenë ende nevojë për mbështetje shtesë p.sh. me fjalor dhe sintaksë pasi mund të kenë vështirësi në dëgjimin e mjaftueshëm të fjalëve, tingujve të fjalëve apo edhe tingujve që ndryshojnë kuptimin e fjalës.
- 3) Disa nga këta nxënës ende nuk kanë qasje të mjaftueshme në një gjuhë të folur për ta përvetësuar natyrshëm atë si gjuhë të parë. Ata mund të kenë një vonesë gjuhësore pasi nuk janë ekspozuar ndaj gjuhës së shenjave dhe për rrjedhojë, nuk kanë pasur ende qasje të mjaftueshme në asnjë gjuhë për të ndërtuar një bazë për komunikim dhe mësim." (Dostal, H. & dhe të tjerë, 2017).

Rekomandimi kryesor i një konference ndërkombëtare të arsimit të të shurdhërve 2010 është si vijon: "Arsimi dygjuhësh është e vetmja mënyrë që fëmijët e shurdhër të fitojnë mundësi të barabarta dhe t'i lejoj ata të bëhen qytetarë të plotë në të drejtën e tyre. Të qenit dygjuhësh në gjuhën kombëtare të shenjave dhe në gjuhën e shkruar të vendit ku fëmiju banon është një e drejtë themelore e fëmijëve të shurdhër. Gjuhët kombëtare të shenjave janë gjuhët amtare të njerëzve të shurdhër dhe e vetmja gjuhë që ata mund ta mësojnë plotësisht dhe pa mundim. Për të funksionuar në shoqëri, është thelbësore që fëmijët e shurdhër të bëhen të aftë në gjuhën

përkatëse (të shkruar) të vendit. Prandaj, dygjuhësia kuptimplotë duhet të sigurohet në arsim sa më shpejt që të jetë e mundur dhe gjatë gjithë rrugës arsimore, duke përfshirë Programet e Mësimnxënies Gjatë Gjithë Jetës." (Federata Botërore e të Shurdhërve, 2011).

Fëmijëve me dëmtime në dëgjim duhet të ofrohet arsimim në gjuhët, mënyrat dhe mjetet e komunikimit më të përshtatshme për individin dhe në mjedise që e maksimizojnë zhvillimin akademik dhe social. Sistemi arsimor, mësimdhënësit, edukatorët dhe prindërit janë përgjegjës për sigurimin e zhvillimit maksimal akademik dhe social, që do të thotë se fëmija me dëmtime në dëgjim ka një mjedis dhe edukim dygjuhësh qysh në fazat e hershme (MASHTI, 2019.)

Gjuha e shenjave mbështet mësimin e gjuhës së folur pasi fëmija mund të verifikojë kuptimin e fjalëve të reja duke përdorur shenja përkatëse ose duke kërkuar sqarime në GjSh. Kur fëmija është dygjuhësh, ai ose ajo mund të zgjedhë cilëndo gjuhë që ai ose ajo mendon se është më e lehtë, më e përshtatshme ose më efektive për të komunikuar me të tjerët ose për të mësuar gjëra të reja (MASHTI, 2019.)

Arsimi cilësor për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim përfshin një sërë elementesh për të siguruar mësim efektiv, komunikim dhe zhvillim të përgjithshëm. Këto elemente përfshijnë qasjen në gjuhën e mësimin, mësimdhënësit të kualifikuar me aftësi të mira në GjSh dhe arsimin dygjuhësh, qasjen në kurrikulë përmes planeve të individualizuara arsimore, bashkëpunimin me mësimdhënësit, specialistët dhe prindërit, shërbimet mbështetëse për nevojat individuale të nxënësit, qasjen në teknologji (p.sh. softuerin arsimor) dhe pajisjet ndihmëse të nevojshme. Që kurrikula të zbatohet në mënyrë efektive, ajo duhet të jetë fleksibile dhe e qasshme për nxënësit e Shurdhër (Mapepa, P. dhe të tjerë, 2018.)

Shkalla e lartë e analfabetizmit të personat e shurdhër mund të shpjegohet me mënyrën apo gjuhën e gabuar arsimore e cila nuk ka arritur të sigurojë mbështetjen e nevojshme pedagogjike për nxënësit e shurdhër që të përvetësojnë shkathtësi të forta të shkrim-leximit. (Tupi, E. 2019). Sipas Strong (2018), profesionistët me cilësi të lartë dhe të përgatitur mirë janë çelësi i mësimin efektiv për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim dhe të gjithë mësimdhënësit kërkojnë ekspertizë në njohuritë profesionale, planifikimin e mësimdhënies, ofrimin e udhëzimeve, vlerësimin, mjedisin mësimor dhe profesionalizëm. (Stronge, J.h. dhe të tjerë, 2018). Mësimdhënësit e nxënësve të shurdhër kanë nevojë për njohuri të forta për shurdhimin, akustikën e të folurit, përvetësimin e gjuhës dhe shkencën e leximit (Scheetz, NA dhe të tjerë., 2008), dhe po ashtu duhet ta zotërojnë gjuhën e shenjave dhe të kenë njohuri të mira të edukimit dygjuhësh (Hartman, MC dhe të tjerë., 2023).

Zhvillimi i gjuhës dhe i shkrim-leximit janë thelbësor për programin arsimor për fëmijët e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim (Pizzo, I. & Chivers, A. 2019). Të lexuarit është një shkathtësi themelore që qëndron në bazë të suksesit në të gjitha fushat akademike. Nxënësit që kanë probleme me lexim ka të ngjarë të kenë gjithashtu probleme në fushat e lëndëve akademike (Rose, S. dhe të tjerë., 2022).

Vlerësimi i shkathtësive gjuhësore dhe atyre të shkrim-leximit është një detyrë sfiduese pasi fëmijët e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim shpesh përdorin një shumëllojshmëri të gjerë të gjuhëve

dhe/ose sistemeve të komunikimit në mjedisë të ndryshme, shtëpi, shkollë dhe komunitet. Gjuha e përdorur në shkollë, në shtëpi dhe në komunitet mund të jetë e ndryshme. Në jetën e përditshme, një fëmijë mund të përdorë gjuhën e folur, gjuhën e shenjave, gjuhën e folur të shenjave ose një sistem të ndërtuar shenjash, i cili huazon veçori nga një gjuhë zyrtare e shenjave, por nuk është njëra në veçanti ose kombinim i ndonjëres. Edhe kur fëmijët përdorin një gjuhë konvencionale, ata mund ta përdorin atë në mënyrë të paqëndrueshme në kontekste të ndryshme. "Kjo papara-shikueshmëri në përdorimin e gjuhës mund të lërë boshllëqe në repertorin gjuhësor të një fëmije, duke e bërë të vështirë vendosjen e gjuhës kryesore që do të përdoret gjatë administrimit të vlerësimit apo edhe cilat gjuhë duhet të përfshihen në vlerësim" (Pizzo, L. & Chilvers, A. 2019).

Nuk ka ndonjë metodë të vetme për mësimdhënien e nxënësve me dëmtim të dëgjimit, sepse të mësuarit për të lexuar ndikohet shumë, ndër të tjera, nga sa mund të përdoret dëgjimi në mësim. Sa më e rëndë të jetë shkalla e humbjes së dëgjimit, aq më sfiduese është të dallosh tingujt e ndryshëm të gjuhës së folur dhe aq më e vështirë është të mësosh gjuhën e folur dhe të shkruar me anë të dëgjimit (Savolainen, A. dhe të tjerë., 2020).

Nxënësit që kanë dëgjim të mbetur përfitojnë nga pajisjet ndihmëse si aparatet e dëgjimit dhe implantet kokleare dhe të mësuarit e tyre për të folur, lexuar dhe shkruar mund të jetë pothuajse si nxënësit që dëgjojnë. Megjithatë, duhet mbajtur mend se ata kanë nevojat e tyre individuale të cilat duhet të plotësohen në mësimdhënie. Modifikimet për mjedisin mësimor duhet të planifikohen siç duhet (akustika, ndriçimi, përdorimi i të folurit etj.).

Për nxënësit e Shurdhër të mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë është më sfiduese pasi gjuha e tyre është gjuha e shenjave. Prandaj, arsimi dygjuhësh është shumë i rëndësishëm pasi promovon zhvillimin e gjuhës së shenjave dhe gjuhëve të folura/shkruara njëkohësisht dhe lehtëson transferimin e shkathtësive ndërmjet gjuhës së shenjave dhe gjuhës së shkruar.

Megjithatë, përvoja e të mësuarit për të shkruar në mesin e fëmijëve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim është unike në atë që shumë prej tyre janë duke u përpjekur të shkruajnë pa ndihmën e një gjuhe të parë të përvetësuar plotësisht. Ky fakt i zvogëlon burimet gjuhësore të nevojshme për të krijuar fjali të sakta sintaksore dhe u paraqet mësimdhënësve të nxënësve të shurdhër nevojën për t'iu qasur mësimin të shkrimit në një mënyrë që llogarit vonesat dhe privimet gjuhësore (Wolbers, K. A. & dhe të tjerë., 2020).

Nxënësit e shurdhër iu qasen informacionit dhe botës përmes mjeteve vizuale dhe prekëse, kështu që strategjitë vizuale luajnë një rol të rëndësishëm në edukimin e të Shurdhërve dhe mësimdhënien e leximit dhe shkrimit për nxënësit e shurdhër. Çdo gjë që është e bazuar në gjuhë, qoftë me gojë apo e shtypur, duhet të mbështetet me mjete ndihmëse vizuale, të tilla si fotografi, demonstrime, video grafike dhe burime multimediale, për të përmirësuar të kuptuarit dhe zhvillimin e fjalorit. Mbështetja vizuale ndihmon në ngushtimin e hendekut midis natyrës vizuale të gjuhës së shenjave dhe gjuhës së shkruar. Për shembull, në mësimdhënien e kohëve të ndërlikuara të foljeve, fotografitë mund të përdoren për të ilustruar veprimet, dhe në theksimin e koncepteve, grafikët ose figurat ndihmojnë të nxënësit e nxënësve. (Yuknis, C dhe të tjerë., 2017).

Mësimdhënësit duhet të planifikojnë siç duhet mënyrën se si i prezantojnë dhe organizojnë pamjet vizuale. Nëse një mësimdhënëës flet ndërsa tregon imazhe vizuale, kjo mund t'i ngatërrojë nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim, të cilët duhet të ndajnë vëmendjen e tyre, ose për ta përcjellur përkthyesin ose për t'i lexuar mimikat e mësimdhënësit dhe për ta shqyrtuar imazhin në të njëjtën kohë. Është mirë t'u jepni kohë nxënësve për të parë pamjet pamore përpara se t'i diskutoni ato. Në këtë mënyrë nxënësit ka të ngjarë të jenë më të angazhuar në mësim (Yuknis, C dhe të tjerë., 2017).

“Disa strategji të tjera për ta bërë klasën më vizuale janë p.sh. përdorimi i gjeesteve, rekuizitave ose lojërave me role për të ilustruar proceset ose idetë; shtimi i paraqitjeve piktorale ose grafike në përmbajtjen e tekstit, krijimi i videove për të treguar se si lidhen idetë, ofrimi i organizatorëve grafikë ose hartave të mendjes, përdorimi i ngjyrave për të koduar konceptet dhe idetë” (Yuknis, C dhe të tjerë., 2017).

Herring T. J. & Woolsey, M.J. (2020) rekomandojnë tri strategji udhëzuese për mësimdhënësit që i mësojnë nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim:

përgjigjet korale, kartat e përgjigjes dhe mësimin me bashkëmohatar. Këto tri strategji kanë treguar se rrisin reagimin aktiv të nxënësve që dëgjojnë në klasa e po ashtu mund të përshtaten me sukses edhe për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim.

Përgjigjet korale dhe kartat e përgjigjeve janë teknika që mund të përdoren për të inkurajuar të gjithë klasën që t'u përgjigjen pyetjeve të mësuesit së bashku. Ato përdoren kur përgjigjet janë të shkurtra. Në përgjigjet korale nxënësit tregojnë përgjigjet e tyre ndaj pyetjes së mësuesit (p.sh. cila është përgjigja e duhur? A... B... C...) me shenja dore. Kartat e përgjigjeve janë karta, shenja ose sende të tjera që të gjithë nxënësit e klasës i mbajnë lart njëkohësisht për t'i shfaqur përgjigjet e tyre ndaj pyetjeve ose problemeve të paraqitura nga mësuesi.

Në mësimin në mes të bashkëmohatarëve, nxënësit çiftohen për rolet e tutorit - tutori dhe nxënësi. Në gjysmë të periudhës së tutorimit, rolet ndërrohen dhe tutori bëhet nxënësi. Tutorët japin informata kthyesë të menjëhershme në përgjigjet e nxënësve të tyre. Përtë llogaritur mospërputhjet midis niveleve akademike të një çifti të mësimdhënësit në mes të bashkëmohatarëve, mund të përdoret materiali udhëzues në kartat flash. Përgjigjet ndaj kërkesave akademike (drejtëshkrimi i fjalëve, përkufizimet etj.) shkruhen ose shtypen në anën e pasme të kartës, në mënyrë që tutori t'i referohet asaj dhe t'i ofrojë reagime udhëzuese nxënësit edhe nëse materiali është mbi nivelin akademik të tutorit. Për studentët e shurdhër, materialet e tutorimit në mes të bashkëmohatarëve mund të përvetësohen duke krijuar një mbajtës karte që i lejon tutorët të përdorin të dyja duart për të komunikuar në GJSH, përderi sa i mbajnë kartat e tutorimit në mes të bashkëmohatarëve lartë. Përdorimi i metodës së mësimdhënies në mes bashkëmohatarëve në mesin e nxënësve të ShVD ka dëshmuar rritje të përgjithshme në të arriturat akademike, si dhe një përmirësim në aftësitë e leximit dhe matematikës dhe aktivitetin fizik.

Teknologjia ndihmëse luan një rol të vlefshëm në mbështetjen e shkathtësive të leximit dhe shkrimit të fëmijëve të shurdhër. Mjete të tilla si: titrat, lexues ekrani, softueri i përpunimit të tekstit

dhe mjetet ndihmëse vizuale ndihmojnë në ngushtimin e hendekut midis gjuhës së shkruar dhe gjuhës së shenjave, duke lehtësuar qasjen në informacion dhe duke promovuar mësimin e pavarur.

Titrat janë një formë e teknologjisë ndihmëse të cilat janë një strategji e dukshme për mësimdhënësit që punojnë me nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim. Titrat e kthejnë atë çfarë thuhet në tekst të shkruar. Ato shfaqen në një ekran ose pajisje, në mënyrë që të mund të lexoni atë që thuhet. Titrat kanë potencial për të përmirësuar shkrim-leximin dhe shkathtësitë gjuhësore që t`ju vijnë në ndihmë nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim, pasi ato u ofrojnë nxënësve qasje në fjalët që thuhet dhe tingujt e rëndësishëm që janë pjesë e videos (Cairns, K. 2014; Yuknis, C dhe të tjerë., 2017).

Hulumtimet kanë treguar se titrat në klasë mund të rrisin të kuptuarit e materialit të folur për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim për ta kuptuar më mirë përmbajtjen e mësimit dhe madje të jenë në gjendje për ta përmbledhur përmbajtjen e mësimit. Po ashtu, kjo mund të gjenerojë një ndjenjë të shtuar të përfshirjes dhe pjesëmarrjes në klasë për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim, që të mund të vazhdojnë me ritmin e mësimit, andaj ndikimi i tyre mund të çojë në përmirësimin e performancës akademike, por edhe në një mjedis më gjithëpërfshirës në klasë me nxënës të shkathtë të cilët mund të marrin pjesë më plotësisht në klasë pasi mund ta kuptojnë se çfarë po ndodh (Cairns, K., 2014).

Instruksioni me Ndhmën e Kompjuterit (CAI) është udhëzim që paraqitet në kompjuter për të ilustruar një koncept përmes animacionit, tingullit dhe demonstrimit tërheqës. Është një teknikë mësimore ndërvepruese në të cilën kompjuteri përdoret për të paraqitur materialin mësimor dhe për të monitoruar mësimin që zhvillohet. Kjo teknikë përdor një kombinim të tekstit, grafikut, tingullit dhe videos për përmirësimin e procesit të mësimnxënies (Adigun, O. T. 2020).

Materialet mësimore për nxënësit e shurdhër duhet të jenë të thjeshta dhe të llojllojshme. Me zhvillimin e TIK-ut, llojllojshmëria është bërë e lehtë dhe aspak e shtrenjtë (Suarsana, I. M. 2021).

Përdorimi efektiv dhe i qëndrueshëm i teknologjisë së dëgjimit, duke përfshirë sistemet e mikrofonit në distancë, për fëmijët që përdorin dëgjimin dhe gjuhën e folur mund të ndihmojë gjithashtu për të kapërcyer sfidat e qenësishme të mësimnxënies në klasat e mëdha dhe të zhurmshme (Hartman, M.C. dhe të tjerë., 2023).

Klasat për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim duhet të pajisen me mjete ndihmëse dhe teknika efektive mësimore të cilat mund ta kompensojnë humbjen në shqisën e dëgjimit. Strategjia konvencionale e mësimdhënies (të shpjeguarit me anë të ilustrimeve/shenjave) mund të paraqesë sfida shtesë për procesin e mësimdhënies-mësimnxënies (Adigun, O. T. 2020.)

Metodat e të mësuarit për të lexuar

Në Finlandë, metoda sintetike KÄTS (metoda shkronja-tingull-rrrokje-fjalë) përdoret shumë në të mësuarit për të lexuar, ku mësimi i të lexuarit fillon me mësimin e korrespondencës shkronja-tingull dhe kalon përmes rrokjeve në leximin e fjalëve dhe fjalive. Meqenëse dëmtimi i dëgjimit

mund ta bëjë të vështirë dëgjimin e tingujve, mësimdhënia duhet të përdorë edhe formën e shkruar dhe/ose alfabetin e gishtave.

Përveç metodës sintetike, shumë nxënës me dëmtime në dëgjim përfitojnë edhe nga metodat analitike me fjalë të plota, siç është metoda e KPL-së. Metoda bazohet në njohjen vizuale të fjalës në tërësi.

Vizualiteti është modaliteti më thelbësor i të mësuarit për të lexuar për një nxënës të shurdhër i cili mëson përmes gjuhës së shenjave. Një nxënës i shurdhër mëson të njohë shkronjat e gjuhës së shkruar duke i koduar ato në alfabetin vizual të gishtave. Alfabetet e gishtave janë forma të dorës në gjuhën e shenjave që shprehin tingujt dhe shkronjat e gjuhëve të folura. Lidhja e ndërsjellë midis shkronjave të shkruara dhe alfabetit të gishtit forcohet me shumë ushtrime të ndryshme në shkrimin e një alfabeti të gishtit dhe formimin e një alfabeti të gishtit nga një shkronjë e shkruar. Nga shkronjat, gradualisht kaloni në metoda të ndryshme të fjalëve të tëra, ku filloni të praktikoni njohjen e figurave të fjalëve nga fjalët në formën bazë të përbërë nga disa shkronja. Nxënësi praktikon ushtrimin/vendosjen e gishtit që korrespondon me shenjën dhe e shkruan atë me shkronja. Pas kësaj, është ende e rëndësishme të shqiptoni fjalën me shenjën e duhur. Përsëritjet e ushtrimit të gishtërinjve dhe shkrimit të fjalëve dhe po ashtu ndërgjegjësimi për shenjat që korrespondojnë me fjalët e mbështesin përvetësimin e fjalëve. Nga fjalët e shkurtra ju kaloni në fjalë më të gjata, në këtë rast nxënësit i kërkohet të mbajë mend një grup më të madh shkronjash (Savolainen, A. dhe të tjerë., 2020).

Në metodën CID, shkronjat e mësuara dhe tingujt e tyre përkatës kombinohen në rrokje dhe pastaj rrokjet e mësuara në fjalë. Mësimdhënia përbëhet nga ushtrime të shumëllojshme të përsëritjes që përfshijnë hapat e mëposhtëm: shqiptim, lexim i buzëve, dëgjim dhe shkrim. Të gjitha fazat përfshijnë gjithashtu ushtrime të kujtesës.

Ushtrimi i gishtërinjve ndihmon në rikujtimin e tingullit që korrespondon me shkronjën dhe e mbështet prodhimin e tyre të mundshëm si tinguj të veçantë. Me ndihmën e gishtërinjve dhe ushtrimeve të ndryshme me shkrim fitohen njëkohësisht prekja, ndjenja e pozicionit dhe ndjesia vizuale. Metoda dhe qasje të ndryshme mbështesin fuqimisht njëra-tjetrën (Siiskonon & Vuorinen 2004, 15).

KPL-ja (metoda e fjalëve të plota) përdoret veçanërisht për ata nxënës që kanë sfida në përvetësimin e gjuhës finlandeze ose në të mësuarit për të lexuar. Për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim, KPL-ja (metoda e fjalëve të plota) zakonisht përdoret në arsimin parashkollor dhe fillor ose si mbështetje në të mësuarit për të lexuar. Fjalori i KPL-së mund të përdoret për të zhvilluar fjalorin e nxënësit dhe për ta njohur këtë të fundit me gjuhën e shkruar finlandeze. Fjalët e fjalorit mësohen të kuptojnë, të prodhojnë gjeste dhe/ose të flasin, njohin, lexojnë dhe shkruajnë. Ju gjithashtu mund të praktikoni drejtshkrimin me anë të gishtit dhe leximin e fjalëve nga buzët. (Savolainen, A. dhe të tjerë, 2020).

Rezultatet

Ideja paraprake e studimit ishte hulumtimi i nivelit të pakënaqshëm i arritjeve në të lexuarit e nxënësve në QB Nëna Terezë e cila ishte edhe baza e këtij studimi. Shkathtësitë e leximit të nxënësve pjesëmarrës në studim u vlerësuan dhe nxënësit morën pjesë në intervistat e fokus grupeve ku u diskutuan praktikrat e tyre të shkrim-leximit dhe përdorimi i gjuhës. Përpara se të vijmë të diskutimet për praktikrat e përditshme të nxënësve, përdorimin e gjuhës dhe rezultatet e intervistave të tjera të fokus grupeve, do të prezantohen rezultatet e vlerësimit të shkathtësive të leximit.

Vlerësimi i shkathtësive të leximit të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim

Mjeti i vlerësimit i përdorur në vlerësimin e rrjedhshmërisë së leximit dhe të kuptuarit e nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim në Qendrën Burimore Nënë Tereza në Prizren ishte testi i leximit në grup¹. Ky instrument bazohet në “test battery” (detyrë mbi rrjedhshmërinë e leximit) e zhvilluar nga Woodcock & Johnson (1989) në gjuhën angleze. Versioni i përshtatur në finlandisht, LUKSU, është zhvilluar nga Instituti Niilo Maki (NMI) në Finlandë në bashkëpunim me Universitetin e Jyväskylä. Para se të përdorej në Kosovë, testi duhej të modifikohej për tu përshtatur me kontekstin kosovar.

Vlerësimi i shkathtësive të leximit mat rrjedhshmërinë e leximit dhe deri diku edhe shpejtësinë e leximit dhe të kuptuarit e leximit. Nxënësit që përdornin këtë test duhej të lexonin fjali të thjeshta, të tilla si “Hekuri është i butë”. Pas leximit të fjalisë, nxënësi duhej të shënonte një kuti nëse fjalia ishte e vërtetë apo e gabuar. Fjalitë ishin aq të thjeshta sa që nxënësit nuk kishin nevojë të mendonin gjatë, nëse ishte e vërtetë apo e gabuar. Në mjetin e vlerësimit kishte 70 fjali dhe kur përdreshin për nxënësit që dëgjojnë ata kishin 3 minuta për të lexuar sa më shumë fjali.

Por, gjatë administrimit të testit me nxënës të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim, u dhamë 15 minuta kohë dhe u shpjeguar se nuk duhet të plotësojnë të gjitha 70 fjalitë, por thjesht të lexojnë me kujdes sa më shumë fjali që të mundën dhe të zgjedhin përgjigjen e duhur. Udhëzuam nxënësit që për ato fjali të cilat nuk janë të sigurt se i kuptojnë saktë, të mos i plotësojnë, pasi plotësimi i gabuar i tyre do t’i hiqte një pikë nga rezultati përfundimtar. Çdo përgjigje e saktë e fjalive në test do t’ju sillte atyre një pikë nga gjithsej 70 pikë. Ndërsa, nëse një fjali plotësohet gabimisht, kjo do t’ju zbriste një pikë nga rezultati përfundimtar. Kjo u përdor si një masë për të kontrolluar hamendjen e përgjigjeve.

Administrimi i testit me nxënës të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim është bërë duke përdorur

1 Test Leximi për Kosovë © Rasanen, Tahiraj, KAPIE & FSDEK II, Prishtinë 2008

përkthyes të gjuhës së shenjave. Po ashtu, të gjitha udhëzimet para dhe gjatë testit janë dhënë në gjuhën e shenjave.

Në test morën pjesë 14 nxënës nga klasa 4 deri në 12. Përzgjedhja e rastësishme e nxënësve nga lista nuk ishte e mundur pasi në shkollë ishin vetëm 30 nxënës dhe disa prej tyre kishin aftësi të tjera të kufizuara si autizëm dhe aftësi të tjera intelektuale. Qëllimi i studimit ishte matja/vlerësimi i shkathtësive të leximit të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim

Rezultatet e testit të leximit të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim

Nr.	Nxënësit	Klasifikimi	Numri i përgjigjeve të sakta	Numri i përgjigjeve të gabuara	Totali i pikëve të fituara nga gjithsej 70
1	N.N	12	0	0	0
2	N.N	12	2	4	0
3	N.N	11	12	4	8
4	N.N	11	5	3	2
5	N.N	11	3	3	0
6	N.N	11	0	1	0
7	N.N	10	0	0	0
8	N.N	9	11	14	0
9	N.N	8	3	4	0
10	N.N	8	2	3	0
11	N.N	7	0	1	0
12	N.N	7	1	0	1
13	N.N	6	0	0	0
14	N.N	4	3	1	2

GRAFIKU 1. Rezultatet e testit të leximit të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim të Qendrës Burimore “Nëna Terezë” në Prizren

Siç mund të shihet nga Grafiku 1, rezultatet e leximit të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim janë jashtëzakonisht të dobëta. Nga gjithsej 14 nxënës që morën pjesë në test, vetëm një nxënës, nr. 3 në listë nga klasa 11 arriti të grumbullojë gjithsej 8 pikë duke shënuar saktë 12 fjali dhe 4 të tjera gabim. Edhe ky rezultat pozitiv nuk tregon se nxënësi është në gjendje të lexojë dhe kuptojë atë që lexohet pasi testi është i ndërtuar në atë mënyrë që ata që e fitojnë shkathtësinë e të lexuarit shumë lehtë të vendosin nëse pohimet në fjali të thjeshta janë të sakta apo të pasakta.

70 deklaratat e testit të leximit të përdorura në vlerësimin e nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim janë shumë të thjeshta dhe të lehta për t'u kuptuar pasi të keni fituar shkathtësinë e leximit. Por, për ta bërë testin në mënyrë korrekte, nxënësit duhej të kuptonin se çfarë po lexonin, gjë që ishte e vështirë për të gjithë nxënësit e shurdhër, të cilët ishin pjesë e vlerësimit. Për shembull, kishte pohime të thjeshta si “Hekuri është i butë” ose “Mizat fluturojnë” dhe nxënësit duhej të vendosnin nëse deklarata/pohimi ishte i saktë apo i pasaktë. Nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim nuk ishin në gjendje t'i lexonin dhe as t'i kuptonin ato pohime të thjeshta.

Nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim, të cilët morën pjesë në vlerësim, dukeshin të habitur dhe në mëdyshje kur ua dorëzuan testin. Kishte gjasë, që kjo ishte hera e parë që testoheshin në lexim. Shumica prej tyre nuk e kuptonin testin dhe donin të hiqnin dorë që në fillim, por pasi në këmbëngulëm, atyre iu desh më shumë kohë për të provuar të lexonin fjalitë dhe ta plotësonin testin. Nuk u deshën pesëmbëdhjetë minutat që dhamë për testin, pasi të gjithë u dorëzuan pas dhjetë minutash.

Duke parë rezultatet e testit, mund të përfundojmë se nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim pas 12 vitesh në shkollë nuk arrijnë të mësojnë të lexojnë dhe të komunikojnë në gjuhën shqipe të shkruar. Ata nuk mund të lexojnë dhe as të kuptojnë fjali të thjeshta. Në të njëjtin test të administruar me nxënësit që dëgjojnë të klasave të dyta, të treta dhe të katërta, fëmijët shënuan saktë nga 20 deri në 70 fjali.

Kjo është një shenjë se metodologjia e përdorur për t'u mësuar leximin dhe shkrimin nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim ka dështuar. Ky dështim duhet të shihet dhe analizohet nga këndvështrime të ndryshme si metodologjia e mësimdhënies dhe e të nxënësve të përdorur nga mësimdhënësit, mënyra e komunikimit dhe gjuha e përdorur gjatë mësimdhënies dhe ndërveprimit me nxënësit, pajisjet dhe materialet e përdorura në procesin e mësimdhënies si dhe faktorët familjarë dhe bashkëpunimi me prindërit.

Nga ajo që u pa gjatë vëzhgimit në klasa, si dhe ajo që u regjistrua gjatë intervistave, tregon se çështja më e madhe dhe faktori kryesor i rezultateve shumë të dobëta në lexim dhe shkrim, janë rezultat i shkathtësive të dobëta të mësimdhënësve dhe stafit tjetër në gjuhën e shenjave dhe gjithashtu mungesa e gjuhës së shenjave si lëndë për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim.

Rezultatet e nxënësve

Qëllimi i intervistave të fokus grupeve të nxënësve ishte të fitonte një kuptim të përvojave dhe pikëpamjeve të nxënësve mbi qëllimet, mësimin, praktikën e përditshme dhe supozimet dhe pritshmëritë mbizotëruese në lidhje me procesin e të nxënësve.

Gjithsej ishin 11 nxënës të shurdhër nga klasa 4 deri në 12 në dy fokus grupe. Plani fillestar ishte që të kishte dy fokus grupe, një për nxënësit e shurdhër dhe një për nxënësit me vështirësi në dëgjim. Duke qenë se të gjithë nxënësit e konsideronin veten të shurdhër dhe e përdorin gjuhën e shenjave si gjuhë komunikimi, fokus grupet u intervistuan me të njëjtat pyetje studimore. Po ashtu, përkthyes të gjuhës së shenjave janë përdorur në intervistat e fokus grupeve. Rezultatet e të dy grupeve janë kombinuar më poshtë.

Shumica e nxënësve e kanë filluar shkollën në Nëna Terezë që në klasën e parë dhe disa prej tyre janë në shkollë prej 11 vitesh. Siç treguan rezultatet e studimit, në testin e të kuptuarit të leximit, asnjë nxënës nuk mund të lexoj dhe shkruaj në gjuhën shqipe të shkruar.

Në të dyja intervistat e fokus grupeve, të gjithë nxënësit ishin shumë aktiv. Ata shprehën hapur përvojat e tyre të të nxënës dhe ishin analitikë në gjetjen e arsyeve për arritjet e tyre shumë të ulëta në mësim. Nxënësit janë të frustruar që ata dhe shqetësimet e tyre për cilësinë e arsimit në shkollë nuk po merren seriozisht.

Ata janë të gatshëm dhe të etur për të mësuar dhe së pari dhe më së shumti për ta mësuar shqipen e shkruar. Ata kanë turp që nuk mund të komunikojnë me njerëzit që përdorin një gjuhë të folur, sepse nuk mund të shprehen as me shkrim. Kjo gjithashtu ndikon në vetë-vlerësimin e tyre. Siç u shpreh një nga nxënësit: "Do të më vijë turp t'u tregoj fëmijëve të mi (në të ardhmen) se nuk di të lexoj dhe të shkruaj." Një nxënës tjetër tha: "Ne jemi të stigmatizuar... ne duam të jemi të barabartë me njerëzit që dëgjojnë."

Edhe pse nxënësit ishin shumë kritikë për cilësinë e mësimdhënies në shkollë, ata kënaqen duke qenë në shkollë sepse aty kanë miq me të cilët mund të shoqërohen.

Qasja në gjuhë dhe praktikat e hershme të shkrim-leximit midis nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim

Përvetësimi i gjuhës në fëmijërinë e hershme ishte i lehtë për fëmijët e familjeve të shurdhëra pasi ata ishin në gjendje të mësonin një gjuhë dhe të komunikonin me të tjerët. Përvetësimi i gjuhës për fëmijët nga familjet që dëgjojnë ishte shumë sfidues pasi ata nuk mësonin asnjë gjuhë dhe kështu nuk mund të komunikonin me të tjerët. Disa nga fëmijët e Shurdhër në familjet që dëgjojnë kishin dikë në familje (nënë, dajën, kushëririn) me të cilin ishte i mundur një lloj komunikimi, ani pse nuk kishte diskutime plotësisht kompetente me ta. Shumë nxënës të Shurdhër filluan të mësojnë gjuhën e tyre të parë, gjuhën e shenjave vetëm pasi filluan shkollën.

Kur nxënësit filluan shkollën, ata përdorën komunikim të plotë dhe ndonjëherë një përkthyes për të komunikuar me mësimdhënësit dhe me anëtarët e tjerë të stafit.

- "Në fillim kur erdha këtu, -- disa prej tyre (mësimdhënësit dhe anëtarët e tjerë të stafit) i dinin disa nga shenjat, por shumica jo. Ishte shumë e vështirë për mua --- Mu duk sikur kisha privim gjuhësor, sepse ata flisnin dhe përdornin drejtshkrimin e gishtave për fëmijën që nuk e di gramatikën."

Shkathtësitë e shkrim-leximit dhe shkrim-leximi shumëgjuhësh i nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim

Nxënësit nuk e kanë mësuar shqipen e shkruar në shkollë. Ata dinë vetëm disa fjalë në shqip, por nuk kuptojnë asnjë fjalë. Sipas nxënësve, pengesat më të mëdha për mësimin e shqipes së shkruar janë mungesa e mësimdhënies cilësore, mungesa e aftësive komunikuese dhe pedagogjike të mësimdhënësve.

Në mësimin e shqipes së shkruar, mësimdhënësit nuk përdorin pamje vizuale që do t'i ndihmonin ata të kuptojnë. Nxënësit marrin tekste të gjata për t'i kopjuar, edhe pse nuk e kuptojnë përmbajtjen

e tekstit dhe mësimit nuk po bëjnë asnjë përpjekje për t'u shpjeguar. Siç e përshkruan një nxënës: *"Duhet të imagjinojmë se cili është kuptimi sepse kur pyesim mësimit, ai/ajo thotë 'bëje vetë', 'mos e bëj me shenja, thjesht shkruaj'. Ndërsa, kur kërkojmë interpretim, mësimit thotë: 'Jo, thjesht shkruani atë.'"* Megjithatë, nxënësit mund të marrin nota të mira edhe nëse nuk kanë mësuar asgjë.

Nxënësit dëshirojnë të kenë më shumë mësim në gjuhën shqipe dhe ta mësojnë shqipen e shkruar, dëshirojnë të kenë mësim në gjuhën e duhur të shenjave, dhe asistent dhe përkthyes të gjuhës së shenjave në klasa pasi sipas tyre *"vetëm me mësimit nuk kuptojmë asgjë"*. Gjithashtu, nxënësit dëshirojnë që mësimit t'u shpjegojë kuptimet e teksteve dhe kur është e nevojshme të ofrojë mbështetjen individuale.

Shumica e nxënësve e kanë dikë në familje që i ofron mbështetje. Sipas nxënësve, prindërit nuk janë të kënaqur me rezultatet e të nxënësve në shkollë dhe veçanërisht me faktin që fëmijët e tyre nuk mësojnë shkrim-lexim. *"Ndihej shumë i turpëruar që nuk lexoj dhe shkruaj, por këtu ekziston një problem i madh."* (një nxënës i shurdhër)

Praktikat e mësimit dhe asistentëve të klasës kur ndër-veprojnë me nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim

Sipas nxënësve të Shurdhër, mësimit nuk janë kompetent në gjuhën e shenjave. Janë vetëm 2 ose 3 mësimit që e përdorin gjuhën e shenjave dhe mësimit e tjerë thjesht flasin. Nxënësit raportuan se u mësojnë mësimit shenja, por ata gjithmonë i harrojnë shumë shpejt.

Nxënësit shpjeguan se mësimit zakonisht shkruajnë një tekst në dërrasën e zezë ose u japin nxënësve një tekst nga libri. Nxënësit duhet ta kopjojnë tekstin në fletoret e tyre edhe pse nuk kuptojnë çfarë është shkruar dhe mësimit nuk japin shpjegimet e duhura.

Asistentët e klasës punojnë për klasat 1 deri në 5 dhe mbështetja e tyre në mësim vlerësohet shumë nga nxënësit, sepse komunikimi me ta është në gjuhën e shenjave dhe *"pasi ata shkruajnë dhe vizualizojnë, për ne është më interesant"*.

Siç shpjeguan nxënësit e shurdhër, kalimi nga klasa e 5-të në të 6-tën duket se është shumë i vështirë për ta. Nxënësit marrin libra me tekst të plotë të cilat nuk i kuptojnë dhe mësimit i detyrojnë ta kopjojnë tekstin në fletoret e tyre pa u shpjeguar përmbajtjen e tekstit. Nxënësit e Shurdhër gjithashtu raportuan se nuk kanë asnjë detyrë shtëpie.

Sipas nxënësve përkthyesit e gjuhës së shenjave janë shumë të mirë dhe nxënësit mësojnë më mirë kur ata janë të pranishëm në klasë. Përkthyesit i bëjnë lëndët më interesante për nxënësit, sepse nxënësit mund ta kuptojnë gjuhën. Ata janë shumë të nevojshëm në klasa, por shumica e mësimit nuk ftojnë përkthyes në klasa edhe nëse nxënësit i kërkojnë. Sipas nxënësve, janë

të paktë mësimdhënësit që përdorin rregullisht përkthyes. Këta mësimdhënës janë po ata që përdorin qasjen dygjuhëshe në mësimdhënie. Problemi është se mësimdhënësit e konsiderojnë veten se e dinë gjuhën e shenjave, por nxënësit nuk i kuptojnë ata. Nxënësit dëshirojnë të kenë gjuhën e shenjave si lëndë në shkollë.

Mjediset dhe materialet mësimore brenda dhe jashtë shkollës

Materialet vizuale dhe pajisjet për ta mbështetur mësimin mungojnë në klasa. Mësimdhënësit përdorin dërrasën e zezë, shkumësin, librat dhe fletoret. Në shkollë ka një laborator kompjuterik, por nxënësve nuk u mësohet në teknologjinë e informacionit. Ata thjesht vizatojnë dhe ngjyrosin me kompjuter. Nxënësit janë të vetëdijshëm për rëndësinë e TI-së në botën e sotme dhe ata pyesin pse TI-ja nuk u mësohet atyre gjatë mësimëve të TI-së.

Intervista e fokus grupit u mbajt në bibliotekë dhe ishte hera e parë që nxënësit ishin atje pasi ajo ishte gjithmonë e mbyllur. Një nxënës vuri në dukje: *"Po, libra të bukur dhe bosh për ne."*

Sipas nxënësve një shkollë ideale do të kishte mësimdhënës të mirë me shkathtësi të mira të gjuhës së shenjave. Do të kishte materiale konkrete, foto të ndryshme, video-projektor dhe video materiale për memorizimin dhe mësimin e shqipes së shkruar; dhe do të kishte asistentë dhe përkthyes të GjSh-së në klasë.

Rezultatet e prindërve

Intervistat e fokus grupeve me prindër synonin të mblidhnin informacion mbi praktikën e hershme të shkrim-leximit jashtë shkollës dhe qasjen në gjuhë dhe arsim, si dhe pikëpamjet e prindërve mbi aspektet që mundësojnë dhe/ose pamundësojnë nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim të arrijnë një nivel të kënaqshëm arritjesh.

Kishte dy fokus grupe të prindërve, një grup kishte gjashtë prindër të Shurdhër dhe tjetri pesë prindër që dëgjojnë. Një përkthyes i gjuhës së shenjave u përdor për të intervistuar prindërit e Shurdhër. Rezultatet e fokus grupeve kishin shumë ngjashmëri. Dallimi kryesor ishte mënyra e komunikimit brenda familjes.

Qasja në gjuhë dhe praktikën e hershme të shkrim-leximit midis nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim

Gjuha në familjet me prindër të shurdhër është gjuha e shenjave e cila ishte një fillim i mirë për fëmijët e Shurdhër që të mësojnë një gjuhë të duhur dhe të komunikojnë me të tjerët që në fëmijërinë e hershme.

Situata në familjet që dëgjojnë ishte e ndryshme. Në disa raste, fëmijët e shurdhër e kaluan tërë fëmijërinë e hershme pa qenë në gjendje të komunikojnë siç duhet me askënd. Prindërit që dëgjojnë nuk e dinin dhe nuk e dinë ende gjuhën e shenjave. Në komunikimin e prindërve që dëgjojnë, zakonisht përdoret një gjuhë e folur, gjeste dhe disa shenja. Nuk kishte asnjë komunikim

të duhur dhe mirëkuptim të përbashkët ndërmjet fëmijës së Shurdhër dhe familjes. Fëmijët mësuhan gjuhën e shenjave kryesisht nga miqtë pasi filluan shkollën në QB Nëna Terezë.

Disa fëmijë janë pajisur me një implant koklear që lejon një farë mase dëgjimi. Megjithatë, ata e konsiderojnë veten të Shurdhër dhe e përdorin gjuhën e shenjave për të komunikuar. Edhe pse ata mund të kuptojnë një gjuhë të folur, ata nuk kanë mësuar të flasin rrjedhshëm për shkak të mungesës së terapisë së të folurit. Prindërit e tyre dëshirojnë ta kenë një logoped në shkollë.

Shkathtësitë e shkrim-leximit dhe shkrim-leximi shumëgjuhësh i nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim

Të gjithë prindërit janë shumë të brengosur për shkollimin e fëmijëve të tyre në shkollë pasi shohin se nxënësit nuk po mësojnë asnjë shkathtësi të shkrim-leximit.

Prindërit e Shurdhër janë të shqetësuar pasi fëmijët e tyre mund të shprehen shumë mirë në GjSh, por nuk e kuptojnë shqipen e shkruar. Prindërit e Shurdhër mund t'i mbështesin fëmijët e tyre në mësimin e gjuhës së shenjave, por jo në shkathtësitë e shkrim-leximit, pasi ata kanë probleme në të kuptuarit e gjuhës së shkruar vetë. Prindërit që dëgjojnë janë të frustruar dhe të pakënaqur me rezultatet e të nxënësve në shkollë pasi nuk po shohin rezultate.

Rrjedhimisht, të gjithë prindërit konsiderojnë se cilësia e arsimit në shkollë është shumë e dobët. Ata janë të habitur dhe madje të zemëruar që fëmijët nuk mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë. Madje, po pyesin veten pse e sjellin fëmijën e tyre në shkollë.

"Unë nuk e di se sa i mësojnë fëmijët."

Praktikat e mësimdhënësve dhe asistentëve të klasës kur ndër-veprojnë me nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim

Sipas prindërve të Shurdhër, shkathtësitë e GjSh-së të mësimdhënësve janë të dobëta. Shumica e mësimdhënësve dhe veçanërisht mësimdhënësit e rinj nuk e përdorin gjuhën e shenjave ndërsa ata që përdorin disa shenja nuk mund të komunikojnë siç duhet dhe nuk mund të kuptohen në gjuhën e shenjave. Prindërit e Shurdhër janë shumë të vetëdijshëm për atë që po ndodh në klasë dhe në shkollë, sepse fëmijët e tyre ua komunikojnë në gjuhën e shenjave. Mesazhi i prindërve është i qartë: mësimdhënësve u mungon gjuha e shenjave dhe shkathtësitë pedagogjike.

Prindërit informuan se fëmijët e tyre nuk po bëjnë asnjë detyrë shtëpie. Gjatë COVID 19 fëmijëve u jepeshin tekste për t'u kopjuar por ata nuk kuptonin asgjë. Prindërit shpresojnë që drejtori i ri të sjellë ndryshim për më mirë në shkollë.

Prindërit duket se kanë një kuptim të përbashkët të arsyeve pse fëmijët nuk mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë në shkollë: "... sepse ata (fëmijët) nuk u mësuhan dhe nuk kishin mundësi të mësonin". Sipas prindërve, mësimdhënësve u mungojnë shkathtësitë pedagogjike dhe komunikuese për edukimin e të Shurdhërve. Ata flasin dhe shkruajnë në dërrasën e zezë dhe fëmijët nuk kuptojnë asgjë. Edhe pse fëmijët e tyre duan të mësojnë më shumë, mësimdhënësit nuk janë të interesuar të japin mësim.

Asistentët e klasës janë të disponueshëm në klasat 1 deri në 5 dhe mbështetja e tyre vlerësohet shumë nga nxënësit dhe prindërit. Prindërit dëshirojnë të kenë asistentë edhe në klasat më të larta. Disa prindër pyesin veten se si fëmijët e tyre mund të marrin notat më të mira edhe nëse nuk lexojnë dhe shkruajnë.

Kuptimi i rrugëve drejt shkrim-leximit, shkathhtësitë gjuhësore dhe arritjet e larta akademike të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim

Prindërit nuk janë të kënaqur me atë që po ndodh në shkollë. Ata dëshirojnë që mësimitdhënësit të kenë më shumë respekt për nxënësit dhe të kujdesen më shumë për fëmijët. Ata kanë dëgjuar se ndonjëherë mësimitdhënësit i quajnë fëmijët e tyre "budallenj".

Prindërit dëshirojnë të kenë shumë ndryshime në shkollë. Ata dëshirojnë që fëmijët e tyre të kenë mësimitdhënie cilësore ku mësimitdhënësit ndjekin një orar më të rreptë në shkollë. Mësimitdhënësit duhet të jenë aktivë gjatë mësimeve, t'u shpjegojnë nxënësve (jo vetëm t'i bëjnë ata të kopjojnë) dhe duhet të ofrojnë më shumë mbështetje gjatë mësimitnxënies. Prindërit gjithashtu dëshirojnë të kenë më shumë asistentë në klasë, trajnime në gjuhën e shenjave për nxënësit dhe materiale më konkrete mësimore të përshtatshme për nxënësit e Shurdhër. "Ata duhet të kenë pasdite të përsëritura me edukatorët, por nuk e bëjnë këtë." Gjithashtu nevojiten materiale për sport.

Të gjithë prindërit janë të shqetësuar për të ardhmen e fëmijëve të tyre pasi ata të lënë shkollën, sepse ata nuk kanë mësuar të lexojnë dhe të shkruajnë.

Rezultatet e stafit arsimor të shkollës

Qëllimi i intervistave të stafit arsimor të QB Nëna Terezë ishte të jepte një pasqyrë në të pesë fushat kryesore të studimit.

Drejtori i shkollës është intervistuar individualisht. Ai është zgjedhur rishtazi në shkollë, tre muaj më parë. Ai nuk e di gjuhën e shenjave, por është i gatshëm të mësojë. Janë intervistuar 7 mësimitdhënës, 3 prej tyre me 1-3 vite përvojë pune dhe 4 të tjerë me mbi 20 vite përvojë pune në shkollë. Tre nga mësimitdhënësit e intervistuar ishin mësimitdhënës të klasës, 2 mësimitdhënës të gjuhës shqipe, 1 mësimitdhënës i AFP-së dhe një mësimitdhënës matematike. Mësimitdhënësit e rinj raportuan se nuk kishin ndonjë trajnim specifik për mësimitdhënien e nxënësve të shurdhër, por përkundrazi ata kishin disa trajnime për arsimin gjithëpërfshirës, ndërsa mësimitdhënësit me përvojë më të gjatë deklaruan se kishin trajnime dhe gjithashtu fituan shumë nga përvoja.

Gjithashtu, dy përkthyes të GjSh-së, 1 instruktor i GjSh-së dhe 3 asistentë të klasës u intervistuan. Asistentët e klasës ishin të shurdhër, dhe janë ish-nxënës të shkollës Nëna Terezë. Njëri vijoi 11 vjeç shkollën, ndërsa tjetri vetëm 4. Ata punojnë në klasat 1 deri në 5.

Në vazhdimësi, janë intervistuar tre edukatore dhe dy infermiere. Shumica e edukatorëve dhe infermierëve të intervistuar kanë një përvojë të gjatë pune.

Qasja në gjuhë dhe praktikat e hershme të shkrim-leximit midis nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim

Sipas ekspertëve të GjSh-së, nxënësit nga familjet e Shurdhëra e njohin GjSh-në kur vijnë në shkollë, ndryshe nga nxënësit që vijnë nga familjet që dëgjojnë. Meqenëse GjSh-ja nuk është si lëndë në plan-program, nxënësit nuk ndjekin asnjë mësim në të. Gjithashtu, përkthyesit dhe instruktori i gjuhës së shenjave nuk lejohen të ofrojnë asnjë trajnim për nxënësit sa i përket GjSh-së. Megjithatë, nxënësit që e fillojnë shkollën pa asnjë gjuhë, e mësojnë GjSh-në mjaft shpejt kur ndër-veprojnë me bashkëmoshatarët.

Nxënësit me implante kokleare nuk ndjekin asnjë terapi të të folurit.

Mësimdhënësit shprehën shqetësimet e tyre për shkathtësitë e GjSh-së të nxënësve të shurdhër. Ata thanë se shumë nxënësve të shurdhër kur vijnë në shkollë u mungojnë shkathtësitë themelore të GjSh-së dhe kjo u krijon probleme në mësimdhënien e koncepteve dhe arritjet akademike të parapara me plan-programin e rregullt. Ata deklaruan se disa nxënës të shurdhër shkojnë dhe qëndrojnë në shkollat e zakonshme dhe pasi kanë dështuar aty vijnë shumë vonë në shkollën tonë. Kjo krijon vështirësi të mëdha për ta në kapjen e kurrikulës së rregullt. Mësimdhënësit raportuan se shkathtësitë e GjSh-së të nxënësve të shurdhër po përmirësohen vazhdimisht gjatë kohës që janë në shkollë, së pari si rezultat i punës së tyre me ta dhe gjithashtu si rezultat i ndërveprimit me bashkëmoshatarët e tyre të shurdhër në shkollë.

Sipas edukatorëve dhe infermierëve, shkathtësitë e GjSh-së të nxënësve janë shumë të mira, veçanërisht të atyre që vijnë nga familje të Shurdhëra. Edukatorët dhe infermierët kanë punuar me nxënës të Shurdhër për një kohë shumë të gjatë dhe ata i konsiderojnë shkathtësitë e tyre të GjSh-së shumë të mira, vetëm njëra prej tyre i konsideron shkathtësitë e saj si të kënaqshme. Ata e kanë mësuar GjSh-në gjatë komunikimit me fëmijët, si dhe marrin pjesë në kursin e GjSh-së që organizohet në shkollë të hënën dhe të premten. Përveç kësaj, ata përdorin të folurin që e bën të mundur leximin e të folurit/buzëve për fëmijët që kanë dëgjim të mbetur. Pyetjes nëse edukatorët u lexojnë fëmijëve libra apo përralla, një nga edukatorët tha se është e vështirë t'i shpjegosh një përrallë një fëmije me aftësi të kufizuara. Ajo e njej GjSh-në, por i konsideron shkathtësitë e saj të GjSh-së jo të mjaftueshme për të treguar përralla.

Shkathtësitë e shkrim-leximit dhe shkrim-leximi shumëgjuhësh i nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim

Drejtori i shkollës është i vetëdijshëm për shkathtësitë shumë të dobëta të nxënësve të shurdhër në gjuhën e shkruar shqipe. Ai tha se duke qenë se nxënësit e shurdhër janë inteligjentë, arsyeja kryesore e tij që ata të mos mësojnë shqipen e shkruar është metodologjia e gabuar e mësimdhënies dhe mungesa e shkathtësive të GjSh-së tek mësimdhënësit. Mendimi i tij është që fillimisht nxënësit e shurdhër ta mësojnë GjSh-në dhe më pas t'u mësohet shqipja e shkruar.

Sipas ekspertëve të GjSh-së, në shkollë nuk ka as edhe një nxënës që di të shkruajë e të lexojë. Nxënësit mund të kenë një kuptim të caktuar në nivel fjalësh, por jo fjali më të gjata se 2-3 fjalë. Arsytet pse nxënësit nuk mësojnë shkathtësitë e shkrim-leximit qëndron te shkathtësitë e GjSh-së dhe atyre pedagogjike të mësimdhënësve. Asnjë nga mësimdhënësit nuk e përdor gjuhën e shenjave dhe/ose qasjen dygjuhëshe. Edhe mësimdhënësit më të vjetër me përvojë të gjatë në shkollë kanë problem me GjSh-në dhe mësimdhënien e shqipes së shkruar.

Nxënësit me prindër të Shurdhër kanë një gjuhë kur fillojnë shkollën, por në mësimin e gjuhës së shkruar janë në të njëjtin nivel me të tjerët sepse mësimdhënësit nuk po i marrin parasysh nevojat e tyre individuale. Gjatë mëimit të shqipes nxënësve u prezantohen shumë fjalë të reja, por nuk ka materiale vizuale në dispozicion që ata t'i kuptojnë ato.

Kur mësimdhënësit u pyetën për shkathtësitë e shqipes së shkruar të nxënësve të shurdhër, ata deklaruan se nxënësit arrijnë të mësojnë deri në nivel fjalësh. Ata thanë se për nxënësit e shurdhër është e vështirë të mësojnë fjali pasi është e ndërlikuar për ta. Kështu, ata nuk mund të komunikojnë në gjuhën e shkruar.

Sipas pedagogëve, komunikimi me shkrim i nxënësve që nuk dëgjojnë është tejet i vështirë. Disa fëmijë dinë disa fjalë të thjeshta. Mesazhet që dërgojnë përmes telefonit janë shumë të thjeshta dhe është e vështirë t'i kuptosh. Në shkrimin e tyre nuk ka lidhëza dhe prapashtesa, por vetëm fjalë që nuk janë të lidhura siç duhet në fjali. Njëri nga informatorët mendon se arsyeja pse fëmijët nuk mësojnë shkrim-lexim është se ata kryesisht shohin fjalë dhe koncepte të shkruara në dërrasën e zezë dhe nuk u shpjegohen shumë mirë. Një informator tjetër theksoi se "nuk mund t'i krahasosh këta fëmijë me aftësi të kufizuara me fëmijët normalë" këta fëmijë harrojnë, përpiqen të shkruajnë disa herë dhe përsëri harrojnë".

Praktikat e mësimdhënësve dhe asistentëve të klasës kur ndër-veprojnë me nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim

Sipas ekspertëve të GjSh-së, nxënësit kanë vështirësi në komunikim me mësimdhënësit pasi këtyre të fundit u mungojnë shkathtësitë e GjSh-së. Shpesh mësimdhënësit përdorin vetëm treguesin që i bën nxënësit nervozë dhe të mërzitur. Deri në klasën e 5-të ka asistentë në klasë dhe nxënësit mund të komunikojnë me ta.

Komunikimi me mësimdhënësit është sfidues edhe për asistentët e klasës për të njëjtën arsye: mësimdhënësit nuk mund të komunikojnë në gjuhën e shenjave dhe asistentët e klasës nuk mund të komunikojnë në gjuhën shqipe të shkruar. Asistentët e dinë shqipen e shkruar vetëm me bazë fjalësh, por nuk i kuptojnë fjalitë e shkruara. Roli i asistentëve ka të bëjë më shumë me këshillimin e nxënësve, plotësimin e nevojave të tyre të ndryshme dhe mbështetjen e shkathtësive të GjSh-së të fëmijëve.

Kur mësimdhënësit u pyetën për shkathtësitë e tyre në gjuhën e shenjave, shumica e tyre raportuan se zotëronin shkathtësi të mira. Edhe mësimdhënësit e rinj deklaruan se e njohin GjSh-në dhe

nxënësit i kuptojnë gjatë orëve të mësimit. Vetëm një nga mësime të mësimdhënësve e reja raportoi se ajo nuk është e mirë dhe nuk ndihet e sigurt në GjSh dhe përdor gjatë gjithë kohës përkthyesin e gjuhës së shenjave në klasë. Një nga mësime të mësimdhënësve e rinj u shpreh se shkathtësitë e tij në gjuhën e shenjave janë të mira, dhe ai mund të arrijë të komunikojë për temat e jetës së përditshme, por në mësime të mësimdhënësve e koncepteve të ndryshme ai ende ka nevojë dhe përdor përkthyesin e GjSh-së.

Mësime të mësimdhënësve me përvojë që morën pjesë në studim u shprehën se kanë shkathtësitë e mjaftueshme të gjuhës së shenjave që nevojiten për mësime të nxënësve të shurdhër dhe se ata mund të komunikojnë dhe kuptohen nga nxënësve të shurdhër kur komunikojnë në gjuhën e shenjave. Por, megjithatë, nxënësve të shurdhër raportuan se shumë shpesh nuk i kuptojnë mësime të mësimdhënësve të tyre në klasë dhe deklaruan se shkathtësitë e mësime të mësimdhënësve për GjSh-në janë shumë të dobëta dhe shprehën dëshirën e tyre për të pasur përkthyes të GjSh-së në klasë.

Mësime të mësimdhënësve gjithashtu raportuan se bazuar në perceptimin e tyre, gjuha e shenjave si gjuhë është shumë e dobët dhe nuk ka një gramatikë të duhur dhe për shumë koncepte që nevojiten në procesin e mësime të mësimdhënësve dhe mësime të nxënësve nuk ka asnjë shenjë në GjSh. Kështu, ata deklaruan se e kanë të vështirë t'u mësojnë nxënësve të shurdhër tema të ndërlikuara dhe gjuhën shqipe të shkruar pasi që GjSh-së i mungon gramatika e duhur, nuk ka lidhëza, nuk ka prapashtesa dhe nuk është e mundur të përdoren folje në kohë të ndryshme.

Tutje, mësime të mësimdhënësve raportuan se ata përdorin komunikimin total në mësime të mësimdhënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim që do të thotë se ata flasin, përdorin shenja, përdorin gjeste dhe shkruajnë në dërrasën e zezë. Ata shpjeguan se në këtë mënyrë është më e lehtë të mësohet në të njëjtën kohë gjuha e shenjave dhe gjuha e shkruar dhe mendojnë se nga përdorimi i komunikimit total mund të përfitojnë nxënësve që të mësojnë të shqiptojnë disa fjalë të folura. Ata po ashtu thonë se shkruajnë shumë në dërrasë të zezë, bëjnë vizatime dhe disa ilustrime prej letre për ta bërë mësime më konkret për nxënësve të tyre. Kjo u vu re edhe gjatë një vëzhgimi në klasë. Mësime të mësimdhënësve përdorin edhe leximin e të folurit/buzëve pasi mendojnë se kjo do t'i ndihmojë nxënësve të shurdhër të kuptojnë më mirë.

Përdorimi i interpretëve në klasë

Kur i pyetëm mësime të mësimdhënësve nëse përdorin përkthyes të GjSh-së në klasat e tyre, ata raportuan se i përdorin sa më shumë që të jetë e mundur, veçanërisht mësime të mësimdhënësve më të rinj që nuk ndihen të sigurt në GjSh. Mësime të mësimdhënësve të klasës na informuan se pasi i angazhuan asistentët e klasës në klasat e tyre, ata nuk kanë më nevojë të përdorin përkthyes të GjSh-së pasi asistentët e klasës janë të shurdhër dhe shumë të rrjedhshëm në gjuhën e shenjave. Por ka pasur raporte se shumë shpesh ka problem në komunikimin mes asistentëve të klasës dhe mësime të mësimdhënësve pasi mësime të mësimdhënësve nuk e njohin gjuhën e shenjave dhe asistentët e klasës nuk janë në gjendje të komunikojnë në shqipen e shkruar dhe kjo krijon probleme në koordinimin dhe përgatitjen paraprake të planit mësime dhe përmbajtjeve mësime. Por, pavarësisht kësaj, asistentët e klasës u raportuan se ishin një burim shumë i mirë dhe i dobishëm në mësime të mësimdhënësve të shurdhër dhe ata janë një ndihmë e madhe për mësime të mësimdhënësve dhe nxënësve të shurdhër.

Sipas ekspertëve të GjSh-së, bashkëpunimi midis mësimeve, përkthyesit dhe asistentit mungon sepse mësimeve nuk i ftojnë përkthyesit e GjSh-së që të vijnë në klasë. Mësimeve japin arsye të tilla si: ata e kuptojnë gjuhën e nxënësve ose se kanë një asistent klase në klasë.

Ndonjëherë asistentët e klasës kanë nevojë për një përkthyes për të komunikuar me mësimeve, por mësimeve nuk duan të ftojnë përkthyes. Ka mësimeve që nuk e dinë GjSh-në dhe prapëseprapë nuk duan të ftojnë një përkthyes në klasë. Fatkeqësisht, kishte një informacion që ish-drejtori u tha mësimeve të rinj se nuk kishin nevojë të punonin me përkthyes të GjSh-së.

Sipas asistentëve të klasës, nuk ka ndonjë planifikim të përbashkët së bashku me mësimeve përpara mësimit. Mësimeve përgatisin materiale dhe gjatë mësimit asistentët e klasës përpigën të japin më shumë informacion vizual që nxënësit ta kuptojnë.

Mjediset dhe materialet mësimore brenda dhe jashtë shkollës

Mësimeve raportuan se në mësimeve e tyre përdorin libra, fletore, stilolapsa, disa ilustrime prej letre të plastifikuara në shkollë, vizatime, dërrasën e zezë dhe shkrim e vizatim në dërrasë të zezë. Sipas tyre, nuk ka laptopë, projektorë dhe teknologji të tjera në dispozicion për ta bërë mësimeve dhe mësimeve më konkrete dhe më tërheqëse. Mësimeve u ankuan gjithashtu se librat që ata përdorin janë shumë të ndërlikuar dhe shumë të vështirë për t'u përdorur me nxënësit e shurdhër, por ata duhet t'i përdorin pasi duhet të ndjekin kurrikulën e rregullt dhe shumë shpesh janë të shqetësuar për të arritur rezultatet e të nxënësit të kurrikulës.

Materialet mësimore që përdoren në klasë dhe mësimeve janë librat, fletoret, dërrasa e zezë, shkrimi. Disa mësimeve përdorin vizatimin. Në klasë nuk ka materiale vizuale dhe pajisje ndihmëse. Materialet janë në dollapët e mësimeve dhe nuk u jepen asistentëve të klasës, madje as fletoret për të punuar me nxënësit.

Sipas drejtorit, ka disa materiale mësimore, por ende ka nevojë për të investuar më shumë në materiale. Si shembull, ekziston nevoja për të përditësuar licencat e Microsoft-it. Ai ka raportuar se në shkollë ka disa projektorë, por mësimeve nuk i përdorin, ndërsa mësimeve kanë thënë se nuk lejohen t'i përdorin.

Detyrat e shtëpisë

Mësimeve janë pyetur edhe për detyrat e shtëpisë, dhe ata kanë thënë se japin detyra shtëpie, por zakonisht nxënësit nuk i bëjnë ato dhe për këtë arsye nuk japin shumë detyra. Detyrat e shtëpisë janë kryesisht me shkrim tekstesh të ndryshme dhe mësimeve thanë se shkrimi për nxënësit e shurdhër është i mërzitshëm dhe jo tërheqës.

Edukatorët bashkëpunojnë me mësimeve për të ditur se çfarë është mësuar gjatë ditës së shkollës dhe çfarë duhet të përforcohet dhe të përsëritet me nxënësit. Edukatorët ofrojnë mbështetje për fëmijët edhe në mësime. Ata kanë 2 orë mësime me nxënës në ditë: 1 orë shqip dhe 1 orë matematikë. Fëmijët ndahen në grupe sipas moshës së tyre. Për shembull, me grupin

e fëmijëve më të vegjël edukatorët ilustrojnë gjëra të ndryshme duke vizatuar dhe shpjeguar se çfarë është në vizatim (për shembull kafshët, frutat etj.). Edukatorët ofrojnë përsëritje të orëve të mësimi në shkollë me nxënësit në mëngjes dhe në mbrëmje, dhe ata i mbështesin nxënësit duke përsëritur detyrat e shtëpisë nëse ka dhe kur nxënësve u mungon mësimi. Sipas tyre duhen përsëritje, pasi nxënësit e shurdhër harrojnë.

Kuptimi i rrugëve drejt shkrim-leximit, shkathtësitë gjuhësore dhe arritjet e larta akademike të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim

Kurrikula dhe Planet Individuale Arsimore (PIA)

Kurrikula e rregullt është duke u përdorur në shkollë dhe sipas mësimdhënësve u krijon shumë vështirësi pasi ata nuk janë të lirë për ta modifikuar përmbajtjen e mësimi. Ata do të preferonin që programi mësimor të përshtatej për nevojat e nxënësve të shurdhër. Mësimdhënësit thanë se përdorin PIA, por sipas informatorëve të tjerë, PIA-të janë të përgatitura por jo në përdorim. Qëllimi i një PIA është të bëjë të mundur diferencimet dhe modifikimet e përmbajtjes së kurrikulës, materialeve mësimore dhe të nxënies për nevojat individuale të një nxënësi.

Siç deklaroi njëri nga mësimdhënësit: *'Jemi të detyruar të ndjekim kurrikulën. Nëse një inspektor vjen në klasën time ose drejtori i shkollës, unë jam i detyruar të ndjek kurrikulën e rregullt'*. Mësimdhënësit ndjekin kurrikulën e rregullt 100% dhe nevojat individuale të nxënësve nuk plotësohen gjatë orëve të mësimi. Sipas informatorëve, mësimet janë gjithmonë të njëjta, por për ditat mësimdhënësit e ndryshojnë lëndën sipas plan-programit. Mësimdhënësit nga klasa e 6-të deri në klasën e 12-të thjesht i detyrojnë nxënësit të shkruajnë ose të bëjnë një kopje të një teksti pa asnjë shpjegim. Ata mund të përdorin një përkthyes për 2-3 minuta vetëm për të dhënë detyrën.

Gjatë mësimi, mësimdhënësit nuk u japin mundësi nxënësve të shprehën, të bashkëveprojnë apo të diskutojnë. Edhe pse mësimdhënësit nuk shpjegojnë asgjë, ata presin që nxënësit ta mësojnë përmendësh tekstin dhe të nesërmen e pyesin veten se si është e mundur që nxënësi nuk e mban mend.

Mësimdhënësit kanë perceptimin se nxënësit e shurdhër harrojnë shumë dhe për këtë arsye nevojitet shumë përsëritje. Ata thanë që ne u mësojmë diçka sot dhe kur vijnë të nesërmen, e harrojnë. Sipas mësimdhënësve, është e zakonshme që të gjithë nxënësit e shurdhër të harrojnë.

Sipas ekspertëve të GjSh-së, meqenëse baza për nxënësit e Shurdhër për të mësuar një gjuhë të shkruar është në vetë GjSh-në, mësimdhënësit duhet ta zotërojnë GjSh-në. Shkathtësitë pedagogjike të mësimdhënësve duhet të përmirësohen dhe ata duhet ta përdorin qasjen dygjuhëshe. Në mësimdhënie duhet të përdoren më shumë materiale dhe veçanërisht materiale vizuale si video, video materialeve me shenja, fotografi, shfaqja e materialeve konkrete dhe po ashtu shumë përsëritje. Mësimdhënësit duhet t'u japin hapësirë shprehjes dhe diskutimit të nxënësve në klasë.

Kur mësimitdhënësit u pyetën se çfarë duhet të ndryshojë në shkollë në mënyrë që nxënësit e Shurdhër të arrijnë më shumë, ata dhanë një listë të gjërave që ata i konsiderojnë si të rëndësishme:

- Të ketë kurrikulë të përshtatshme për nxënësit e shurdhër
- Të ketë më shumë laptopë, tabletë dhe teknologji në përdorim për ta bërë mësimitdhënien dhe të nxënit më tërheqës
- Të ketë metodologji të mësimitdhënies për nxënësit e shurdhër
- Të ketë ekip multi-disiplinar (psikolog, logoped, pedagog)
- Të ketë trajnim të GjSh-së për nxënësit

Ekspertët e GjSh-së sugjeruan që për të përmirësuar bashkëpunimin në klasë, mësimit duhet të planifikohen, dhe materialet duhet të përgatiten së bashku me një asistent dhe mësimitdhënësit duhet të tregojnë një ditë më parë se çfarë do të mësohet gjatë orës së mësimit të nesërmen.

Dëshira të tjera që u prezantuan ishin:

- GjSh-ja duhet të jetë një lëndë e përfshirë për të paktën 3-4 orë në javë në kurrikulë.
- Drejtori duhet të kërkojë nga përkthyesit, instruktorit dhe asistentët e GjSh-së që të vlerësojnë shkathtësitë e mësimitdhënësve në GjSh.

Edukatorët dhe infermierët dëshirojnë që të ketë më shumë bashkëpunim me mësimitdhënësit dhe stafin tjetër dhe të krijohet një ekip multi-disiplinar në shkollë.

Mungesa në shkollë

Mësimitdhënësit u ankuan se nxënësit po bëjnë shumë mungesa në shkollë.

Informatorë të tjerë ngritën çështjen e mungesës së shpeshtë të mësimitdhënësve në shkollë.

Trajnimi për GjSh-në në shkollë

Sipas drejtorit, kurset për GjSh-në, të organizuara për stafin nuk po ndiqen rregullisht nga të gjithë mësimitdhënësit. Plani i tij është të organizojë një test për shkathtësitë e GjSh-së të mësimitdhënësve dhe të vendosë në rregull të gjithë procesin.

Kur mësimitdhënësit u pyetën për kursin e GjSh-së të organizuar në shkollë, ata raportuan se vetëm mësimitdhënësit e rinj vazhdojnë të ndjekin kurset. Mësimitdhënësit më të vjetër deklaruan se e kanë ndërprerë kursin pasi po shpjegohen të njëjtat gjëra si në kursin e mëparshëm dhe kjo po bëhet e mërzitshme për ta.

Mësimitdhënësit gjithashtu deklaruan se GjSh-ja që po mësohet në kurs është e dobët dhe i mungojnë shumë konceptet, gramatika e duhur dhe veçanërisht kohët e foljeve, gjë që është e vështirë për ta për t'u kuptuar dhe përdorur në procesin e përditshëm të mësimitdhënies dhe të nxënit me fëmijët e shurdhër. Ata u shprehën se do të dëshironin që në lëndë të kishte tema më të ndërlikuara, jo vetëm fjalë, por edhe fjali të ndërlikuara me ilustrime dhe shembuj konkretë,

në mënyrë që të mësonin shprehje në GjSh për tema të ndryshme komplekse që u nevojiten në mësimdhënien e nxënësve të shurdhër në lëndë të ndryshme. Ata gjithashtu shprehën dëshirën dhe vullnetin për të mësuar më shumë dhe për të përmirësuar shkathtësitë e tyre në GjSh.

Përmbledhje e anketës së mësimdhënësve në internet

Për të përfshirë në studim më shumë mësimdhënës dhe personel tjetër të QB-së në Prizren, u krye një anketë e mësimdhënësve në internet dhe u hartua një pyetësor në Google me shkallën Likert dhe dy pyetje të hapura (shih shtojcën). Synimi i anketës ishte të mblidheshin perceptimet e mësimdhënësve dhe stafit tjetër lidhur me situatën e arsimit të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim në shkollën Nëna Terezë. Gjithsej ishin 20 pjesëmarrës duke përfshirë mësimdhënësit, edukatorët dhe drejtorin e shkollës.

Pyetjet në pyetësor mbulonin tema nga më të ndryshmet lidhur me kushtet dhe burimet në shkollë dhe në përgjithësi situatën e arsimit të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim

Tek deklarata “MASHTI n`a ofron burime dhe mbështetje të vazhdueshme” 13 nga të anketuarit e pyetësorit u shprehën të kënaqur me burimet dhe mbështetjen e ofruar nga MASHTI. E njëjta kënaqësi e të anketuarve u deklarua edhe për infrastrukturën shkollore dhe mjedisin për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim. Por kjo është paksa kontradiktore, pasi shumë të anketuar të pyetur për sfidat në shkollë kanë përmendur infrastrukturën e keqe të shkollës, kabinetet dhe teknologjinë që po u mungon në shkollë.

Të 20 të anketuarit mendojnë se Qendra Burimore në Prizren është alternativa më e mirë për arsimim e nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim. Ndërsa, prindërit dhe nxënësit gjatë intervistave në fokus grup nuk ndanë të njëjtin mendim.

12 nga të anketuarit e konsiderojnë kurrikulën e rregullt shumë të rëndësishme dhe pajtohen plotësisht se duhet ta ndjekin atë. Për kërkesat e kurrikulës dhe përshtatjen e saj, 9 e të anketuarve mendojnë se kërkesat e kurrikulës së rregullt e vështirësojnë përmbushjen e kërkesave të kurrikulës për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim, 7 ishin neutral ndërsa 2 prej tyre nuk u pajtuan me deklaratën. 9 e të anketuarve deklaruan se pajtohen ose pajtohen fuqimisht se nuk ka materiale të përshtatura për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim, 8 prej tyre ishin neutral ndërsa 3 prej tyre nuk u pajtuan. Mungesa e materialeve të adaptuara u tha edhe në të gjitha intervistat në fokus grupe dhe ishte e dukshme gjatë vëzhgimeve në klasë.

